# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5575
E enjte, 13 shtator 2018
çmimi 0.40 €


## Thaçi fton shqiptarët e Maqedonisë ta mbështesin referendumin e 30 shtatorit

FAQE 3




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", MIMOZA KUSARI-LILA FAQE 4-5

# Shqiptarët e Luginës t'i kenë të drejtat e serbëve të Kosovës



Kryetarja e Alternativës, Mimoza Kusari-Lila, ka thënë se qëndrimi i subjektit të saj politik është që Kuvendi i Kosovës sa më parë të miratojë një rezolutë e cila do t'i përfshijë shtyllat e dialogut për fazën finale me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka theksuar se një ndër pikat e kësaj rezolute duhet të jetë reciprociteti i të drejtave si bazë e marrëveshjes në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Ajo që garantohet për pakicën serbe në Republikën e Kosovës të garantohet edhe për pakicën shqiptare në Republikën e Serbisë", ka thënë Kusari-Lila, duke shtuar se Alternativa do të insistojë që të arrihet konsensusi kombëtar midis pozitës dhe opozitës për tri çështje: për mosndryshim të kufijve të Kosovës, për përcaktimin e objektivave të qarta në platformën e bisedimeve në Bruksel dhe për mandatimin e ekipit negociues në Bruksel. Kusari-Lila ka thënë se të tri këto çështje duhet të ngrihen përmbi politikën ditore dhe përmbi pozicionet aktuale të partive politike

KRYEPARLAMENTARI KADRI VESELI, I SHOQËRUAR EDHE NGA ZËVENDËSKRYEMINISTRI FATMIR LIMAJ DHE DARDAN GASHI, KA QËNDRUAR TË MËRKURËN PËR VIZITË NË SHQIPËRI

# Presidenti Meta bën thirrje për unitet politik për dialogun me Serbinë



Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, gjatë takimit që ka pasur me kryeparlamentarin Kadri Veseli dhe zëvendëskryeministrin Fatmir Limaj dhe Dardan Gashi, ka theksuar se në procesin e dialogut me Serbinë, shteti i Kosovës duhet të ketë konsensus të gjerë politik, duke i ftuar partitë opozitare t'i marrin përgjegjësitë që u takojnë në këtë proces FAQE 2




## 'Çohu': Financimi i partive politike, proces i pakontrolluar

FAQE 6

## AKTUALE

**OPOZITA I SHKRUAN LETËR MOGHERINIT RRETH FAZËS SË FUNDIT TË DIALOGUT** F. 6

**MINISTRJA HOXHA FTON DEPUTETËT T'I VOTOJNË DY PROJEKTLIGJET PËR PROCESIN INTEGRUES** F. 3

**BYTYQI: FUSHË-KOSOVA KA NEVOJË PËR NDËRTIMIN E SHKOLLAVE TË REJA** F. 11

## EKONOMI

**HOXHA THOTË SE PUNËTORËT E POSTËS KANË MBETUR PA PAGA SHKAKU I QEVERISË** F. 9

**AMBASADA AMERIKANE VLERËSON PUNËN E KEK-ut** F. 8

## KULTURË

**NË MALISHEVË SHËNOHET DITA E RINISË ME DHJETËRA AKTIVITETE** F. 10

## SPORT



**FLAMURTARIN S'KA KUSH QË E NDAL, DRITËN E 'SHKUNDË' LLAPI**

**SONTE KOSOVA PËRBALLET ME MAQEDONINË** F. 12


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Kryeparlamentari Kadri Veseli, i shoqëruar edhe nga zëvendëskryeministri Fatmir Limaj dhe Dardan Gashi, ka qëndruar të mërkurën për vizitë në Shqipëri

# Presidenti Meta bën thirrje për unitet politik për dialogun me Serbinë

Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, gjatë takimit që ka pasur me kryeparlamentarin Kadri Veseli dhe zëvendëskryeministrin Fatmir Limaj dhe Dardan Gashi, ka theksuar se në procesin e dialogut me Serbinë, shteti i Kosovës duhet të ketë konsensus të gjerë politik, duke i ftuar partitë opozitare t'i marrin përgjegjësitë që u takojnë në këtë proces



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

**Tiranë, 12 shtator** - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli, i shoqëruar edhe nga zëvendëskryeministri Fatmir Limaj dhe Dardan Gashi, kanë qëndruar të mërkurën për vizitë zyrtare në Shqipëri. Veseli është pritur në Tiranë nga presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, të cilin e ka informuar për zhvillimet politike në vend dhe për fazën finale të dialogut me Serbinë.

Kryeparlamentari Veseli ka theksuar qëndrimin e Republikës së Kosovës se në fazën finale të dialogut Kosova synon njohjen e pavarësisë nga Serbia dhe hapjen e rrugës për anëtarësim në OKB, NATO, BE dhe organizata të tjera ndërkombëtare. Ai ka theksuar se në këtë proces institucionet e Kosovës duhet të jenë të unifikuara dhe të kenë konsensus të gjerë nga forcat politike parlamentare. Veseli ka thënë se integriteti dhe sovraniteti i Kosovës janë të pacenuar dhe të panegociueshme.

Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka thënë se Shqipëria po ndjek nga afër këtë proces dhe do të jetë e gatshme ta ndihmojë Kosovën në të gjitha fazat. Ai ka theksuar se në procesin e dialogut shteti i Kosovës duhet të ketë konsensus të gjerë politik dhe me këtë rast ka thënë se edhe partitë opozitare duhet t'i marrin përgjegjësitë që u takojnë dhe të gjithë së bashku të ndërtojnë platformë shtetërore dhe ekip për dialogun.

Në kuadër të kësaj vizite delegacioni i Kosovës është pritur në takim edhe nga kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, Gramoz Ruçi. Në këtë takim të dy homologët diskutuan për proceset nëpër të cilat po kalojnë të dyja vendet, ndërsa temë bosht e takimit ishte dialogu midis Kosovës dhe Serbisë.

Kryeparlamentari Veseli ka thënë se Kosova është duke shkuar me vendosmëri në fazën e fundit të dialogut me Serbinë. "Rrugëtimi ynë është perëndimor. Vuçiqi nuk mund ta dëmtojë sovranitetin tonë me ardhje në Kosovë dhe asnjë deklaratë tjetër. Ajo që e dëmton aktualisht Kosovën është mungesa e unitetit. Jemi krenarë që kemi partnerë siç janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe se jemi krah me vendet që janë perëndimore", ka thënë Veseli.

Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, Gramoz Ruçi, ka pohuar se kryefjala e bashkëbisedimit në këtë takim ishte tema e dialogut Kosovë - Serbi. Ai ka thënë se Shqipëria ka qenë, është dhe do të jetë mbështetëse e parezervë e dialogut Kosovë - Serbi, me BE-në si destinacion të të dyja shteteve.

Zëvendëskryeministri i Kosovës, Famir Limaj, Limaj ka thënë se në fazën finale të dialogut duhet të udhëhiqen nga Deklarata e Pavarësisë së Kosovës, Kushtetuta dhe opinioni i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. "Në këto takime përçuam mesazhin se të gjithë duhet të jemi bashkë dhe se dialogu me Serbinë nuk është çështje me të cilën kalkulohet në vota. Në dialogun Kosovë - Serbi ne udhëhiqemi nga Deklarata e Pavarësisë, nga Kushtetuta e vendit si dhe nga vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Sa i përket fazës finale me Serbinë, Kosova hyn në këtë fazë me objektiv të qartë: arritjen e një marrëveshjeje përfundimtare me Serbinë, e cila nënkupton njohjen e Kosovës si dhe anëtarësimin e Kosovës në OKB dhe organizma të tjerë ndërkombëtarë", ka thënë Limaj.



## Veseli takoi edhe Sali Berishën dhe kryetarin e PD-së, Lulzim Basha

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, i shoqëruar edhe nga Limaj e Gashi, ka zhvilluar takime të ndara me ish-kryeministrin e Shqipërisë, Sali Berisha dhe kryetarin e Partisë Demokratike, Lulzim Basha. Në këto takime u diskutua për zhvillimet aktuale politike në të dyja vendet, me theks të veçantë për procesin e dialogut midis Kosovës dhe Serbisë dhe për arritjen e marrëveshjes përfundimtare.

Kryeparlamentari Veseli ka thënë se te Sali Berisha Kosova gjithherë ka gjetur mbështetësin e madh e të parezervë gjatë rrugëtimit të saj për liri, pavarësi dhe shtetndërtim. Duke folur për procesin e dialogut me Serbinë, Veseli ka theksuar se Kosova është shtet i pavarur sovran dhe se askush nuk mund ta ndajë atë e as të bëjë 'Republikë serbe' brenda saj.

Ish-kryeministri Sali Berisha ka thënë se dialogu dhe marrëveshja midis Kosovës dhe Serbisë janë të një rëndësie të madhe jo vetëm midis këtyre dy vendeve, por për rajonin në tërësi. "Ndaj mendimin se integriteti territorial i Kosovës dhe sovranitetit nuk janë dhe nuk mund të jenë në asnjë rrethanë çështje diskutimi. Askush nuk ka të drejtë ligjore as kombëtare të hapë diskutim për çështjen e kufijve të Kosovës. Denoncoj me forcën më të madhe përpjekjet e Beogradit për të krijuar struktura të ngjashme me 'Republika Srpska' në Kosovë. Ky është mekanizëm i shpifur i Beogradit për destabilizim. Thirrja ime për të gjitha partitë është të ulen së bashku në shembullin më të mirë të Vjenës, ta votojnë në Parlament kornizën e këtij diskutimi dhe ta krijojnë delegacionin e përbashkët. Kosova meriton të votojë së bashku një kuadër ligjor, i cili nuk do të kundërshtohej nga askush më", ka thënë Berisha.

## Sekretari amerikan i Mbrojtjes viziton Shkupin

**Shkup, 12 shtator** - Sekretari amerikan i Mbrojtjes, James Mattis, paralajmëroi se fundjavën e ardhshme do ta vizitojë Maqedoninë që të shprehë përkrahje të qartë për referendumin e ardhshëm për çështjen e emrit, por edhe shqetësim për shkak të përfshirjes së mundshme të Moskës në këtë proces. "Do të shkoj t'i vizitoj miqtë tanë të Maqedonisë dhe qartë do të bëj me dije se ShBA-ja e përkrah popullin e Maqedonisë", tha Mattisi në deklaratë për gazetarët në Pentagon.

Mattisi theksoi se është i brengosur se Rusia mund të përfshihet në procesin e referendumit në Maqedoni. "Nëse keni votim, Moska do të përfshihet. Unë jam i brengosur për atë. Përzierje të tillë Rusia ka praktikuar nga Estonia deri në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga Ukraina dhe tani në Maqedoni, gjithmonë adaptohet me situatën konkrete", tha sekretari amerikan i Mbrojtjes.



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka qëndruar për vizitë zyrtare në Maqedoni, ku është pritur nga liderët shtetërorë të këtij shteti

# Thaçi fton shqiptarët e Maqedonisë ta mbështesin referendumin e 30 shtatorit

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, të mërkurën ka vizituar Maqedoninë për t'i dhënë mbështetje referendumit të 30 shtatorit. Ai u ka bërë thirrje qytetarëve në Maqedoni, sidomos shqiptarëve, që të votojnë pro referendumit, duke kontribuuar për të ardhmen evropiane. Thaçi ka vlerësuar se e ardhmja e Kosovës, e Maqedonisë dhe e tërë rajonit tonë është në NATO dhe në Bashkimin Evropian



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 12 SHTATOR - Presidenti i shtetit të Kosovës, Hashim Thaçi, të mërkurën gjatë vizitës zyrtare në Shkup u ka bërë thirrje qytetarëve të Maqedonisë, sidomos shqiptarëve, që të dalin dhe të votojnë pro marrëveshjes për emrin në referendumin e 30 shtatorit. Ai ka thënë se votimi pro marrëveshjes së Maqedonisë me Greqinë për emrin do ta vuloste të ardhmen euroatlantike të Maqedonisë. "Ftoj, me autoritetin tim modest, në emër të Kosovës, si një vend fqinj me Maqedoninë, që të gjithë njerëzit, qytetarët e Maqedonisë, pa dallim, të marrin pjesë në referendum dhe natyrisht të votojnë për. Maqedonia në NATO është më tepër paqe për të gjithë rajonin, duke përfshirë këtu edhe Kosovën. Kështu që, ky është një moment historik që duhet të shfrytëzohet", ka deklaruar presidenti Thaçi në një konferencë të përbashkët për medie me kryeministrin e Maqedonisë, Zoran Zaev.

Më pas presidenti Thaçi ka folur për procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, duke thënë se arritja e marrëveshjes do të jetë e vështirë por, siç ka thënë ai, të dyja shtetet nuk duhet të mbeten peng i mosmarrëveshjeve. Thaçi ka vlerësuar se kjo marrëveshje do ta ndihmonte Kosovën të ecë më shpejt drejt perspektivës euroatlantike, kurse Serbinë drejt së ardhmes evropiane. "Dialogu është rruga e vetme që të arrihet një marrëveshje historike përfundimtare e paqes, që nënkupton njohjen reciproke ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Marrëveshja do të jetë shumë e vështirë për t'u arritur, dhe ka plot pengesa, por unë jam optimist se më mirë ta kryejmë tash këtë marrëveshje sesa pas një dekade ose dy dekadash", është shprehur Thaçi.

Ai ka bërë me dije se marrëveshja Kosovë - Serbi nuk pritet ta pengojë dhe cenojë integritetin territorial të Maqedonisë apo të shteteve të tjera të rajonit. Në këtë kontekst, Thaçi ka thënë se Kosova e respekton integritetin territorial të çdo shteti fqinj, por me Serbinë është çështje specifike. "Marrëveshja Kosovë - Serbi, nëse arrihet, do të jetë e frymës evropiane, do të jetë e koordinuar plotësisht me ShBA-në dhe BE-në, shtetet fqinje dhe shtetet mike do të ndihen rehat. Kosova e respekton integritetin territorial të çdo shteti fqinj, të Maqedonisë, të Shqipërisë dhe të Malit të Zi dhe të vendeve të tjera, por me Serbinë është çështje specifike", ka theksuar Thaçi. Ai ka thënë se Kosova dhe Maqedonia po bëjnë hapa të rëndësishëm të bashkëpunimit në interes të dy vendeve dhe popujve. "Autostrada Prishtinë - Shkup është duke shkuar drejt përfundimit në pjesën e Kosovës, kurse së shpejti pritet të nisin punimet edhe prej kufirit në drejtim të Shkupit. Si liderë institucionalë dhe politikë e kemi për obligim të punojmë më shumë për vendin sesa për momentumet populiste apo elektorale", ka thënë Thaçi.



Ndërsa kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev, ka përshëndetur dialogun midis Kosovës dhe Serbisë, duke vlerësuar se është shumë e rëndësishme që liderët e rajonit të bashkohen në rrugën drejt integrimit euroatlantik. Ai ka bërë me dije se Kosova e ka mbështetjen e Maqedonisë për arritjen e një marrëveshje pozitive me Serbinë. Zaevi ka thënë se është i interesuar të zgjidhen të gjitha kontestet rajonale me qëllim që i gjithë Ballkani Perëndimor të bëhet një vend më i sigurt për jetë dhe investime. "Përparimin në këtë drejtim e vlerësojmë si vendimtar për një stabilitet dhe zhvillim të qëndrueshëm rajonal. Maqedonia mbështet zgjidhjen pozitive për Kosovën, një zgjidhje që do ta përmirësojë gjendjen dhe mirëqenien edhe të shqiptarëve, edhe të serbëve, edhe qytetarëve të tjerë në Kosovë. Zgjidhje që do të jetë e mirë për Kosovën dhe për të gjithë rajonin tonë. Për mua është e rëndësishme që të gjithë liderët e rajonit të qëndrojmë të bashkuar për përmbushjen e qëllimeve të përbashkëta që i kemi, e këto janë: paqja afatgjatë, zhvillimi ekonomik, bashkëpunimi rajonal dhe anëtarësimi në BE", ka deklaruar Zaevi.

Kryeministri i Maqedonisë ka folur edhe për bashkëpunimin ekonomik me Kosovën, veçanërisht për investimet në infrastrukturë.

## Thaçi merr përkrahje nga Ali Ahmeti për arritjen e marrëveshjes Kosovë - Serbi



Në kuadër të vizitës në Maqedoni presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, është pritur në takim edhe nga lideri i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, nga i cili ka marrë mbështetje për çfarëdo marrëveshje që do të arrihet në mes të Prishtinës dhe Beogradit. Me këtë rast, Ahmeti ka thënë se është e rëndësishme që Kosova dhe Serbia t'i përmbyllin sa më shpejt çështjet e hapura meqë rajoni ka nevojë për progres. "E sigurova presidentin Thaçi se ne do të jemi përkrahës të fortë për çdo zgjidhje që do të arrijnë institucionet e Kosovës për shënimin e vijave të demarkacionit me palën serbe. Janë çaste të rëndësishme dhe historike për Kosovën që edhe ky problem të përmbyllet sepse rajoni ka nevojë për progres", ka deklaruar Ahmeti.

Gjatë vizitës në Maqedoni, presidenti Thaçi është pritur në takim edhe nga kryetari i Parlamentit, Talat Xhaferi.

## Ministrja Hoxha fton deputetët t'i votojnë dy projektligjet për procesin integrues

PRISHTINË, 12 SHTATOR (ER) - Kuvendi i Republikës së Kosovës sot (e enjte) pritet ta mbajë seancën e parë të sesionit pranveror të kësaj legjislature. Në këtë seancë, e cila pritet fillojë në orën 10:00, në rend ditë janë 40 pika të ndryshme.

Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka ftuar deputetët ta rikonfirmojnë unitetin, duke miratuar dy projektligje të rëndësishme për procesin integrues.

Projektligjet që pritet të votohen janë: Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes financiare IPA 2017, pjesa e parë, ndërmjet Kosovës dhe BE-së; Marrëveshja ndërmjet Kosovës dhe BE-së për pjesëmarrjen e Kosovës në programin "Evropa për qytetarët", vlera e Marrëveshjes së parë është 48 milionë euro, ndërsa e dyta përmban fonde me vlerë 187 milion euro.

Sipas ministres Hoxha, miratimi i këtyre dy projektligjeve i mundëson Kosovës qasje të menjëhershme në programe të dobishme për shumë fusha me rëndësi.

Flet për "Epokën e re", Mimoza Kusari-Lila

# Shqiptarët e Luginës t'i kenë t



Kryetarja e Alternativës, Mimoza Kusari-Lila, ka thënë se qëndrimi i subjektit të saj politik është që Kuvendi i Kosovës sa më parë të miratojë një rezolutë e cila do t'i përfshijë shtyllat e dialogut për fazën finale me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka theksuar se një ndër pikat e kësaj rezolute duhet të jetë reciprociteti i të drejtave si bazë e marrëveshjes në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Ajo që garantohet për pakicën serbe në Republikën e Kosovës të garantohet edhe për pakicën shqiptare në Republikën e Serbisë", ka thënë Kusari-Lila, duke shtuar se Alternativa do të insistojë që të arrihet konsensusi kombëtar midis pozitës dhe opozitës për tri çështje: për mosndryshim të kufijve të Kosovës, për përcaktimin e objektiva të qarta në platformën e bisedimeve në Bruksel dhe për mandatimin e ekipit negociues në Bruksel. Kusari-Lila ka thënë se të tri këto çështje duhet të ngrihen përmbi politikën ditore dhe përmbi pozicionet aktuale të partive politike

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 12 SHTATOR - Kryetarja e Alternativës, Mimoza Kusari-Lila, ka deklaruar se në rezolutën e Kuvendit për fazën finale të dialogut Kosovë - Serbi duhet të përfshihet edhe çështja e shqiptarëve të Luginës së Preshevës. Ajo ka vlerësuar se bazë e një marrëveshje të mundshme në mes të dy vendeve duhet të jetë reciprociteti i të drejtave të pakicave. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Kusari-Lila ka thënë se ajo që u garantohet serbëve në Kosovë duhet t'u takojë edhe shqiptarëve të Luginës. "Qëndrimi i Alternativës është se Kuvendi i Kosovës sa më parë duhet ta miratojë një rezolutë e cila do t'i përfshijë shtyllat e dialogut për fazën finale me Serbinë. Një ndër pikat e kësaj rezolute duhet të jetë reciprociteti i të drejtave si bazë e marrëveshjes në mes të Kosovës dhe Serbisë. Domethënë, ajo që garantohet për pakicën serbe në Kosovë të garantohet edhe për pakicën shqiptare në Republikën e Serbisë", ka thënë Kusari-Lila.

Ajo ka vlerësuar se kërkesa për bashkimin e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës me Kosovën është e pamundshme. Sipas Kusarit, një rezolutë për bashkimin me Kosovën mund t'u sjellë pasoja të rënda shqiptarëve të asaj pjese. "Konsideroj se kjo shkon përtej vijave politike ditore, përtej qëndrimeve pozitë dhe opozitë, sepse është në interes kombëtar. Është koha e fundit që shqiptarët e Luginës të jenë të përfaqësuar dinjitetshëm dhe natyrisht të mos bëhen manipulime dhe pazare në emër të tyre, pastaj të shkaktohen pasoja të parikuperueshme. Të gjithë e dimë se një rezolutë e cila do ta parashihte bashkimin e tri komunave të Luginës së Preshevës me Kosovën do të jetë me pasoja më të rënda për shqiptarët e asaj ane. Kjo mund të rezultojë me shpopullim, me migrim masiv dhe me represione të tjera të shtetit serb ndaj tyre", është shprehur ajo.

Kryetarja e Alternativës ka deklaruar se, përveç kësaj çështje, rezoluta duhet t'i përmbajë edhe tri pikat e tjera në raport me dialogun Kosovë - Serbi. "Alternativa do të insistojë që të arrihet konsensusi kombëtar midis pozitës dhe opozitës për këto çështje: së pari për mosndryshimin e kufijve të Kosovës; së dyti për përcaktimin e objektiva të qarta në platformën e bisedimeve në Bruksel; së treti për mandatimin e ekipit negociues në Bruksel. Të tri këto çështje duhet të ngrihen përmbi politikën ditore, përmbi pozicionet aktuale të partive politike, sepse kjo ka të bëjë me interesin kombëtar", ka thënë Kusari-Lila, duke shtuar se miratimi i ekipit të delegacionit negociues duhet të mandatohet pasi Kuvendi i Kosovës ta miratojë platformën për bisedime.

**"Epoka e re":** *Znj. Kusari-Lila të mërkurën keni vizituar Komunën e Bujanocit, ku jeni takuar me udhëheqjen e kësaj komune. Cili ka qenë qëllimi i kësaj vizite?*

**Kusari-Lila:** Qëllimi i vizitës ishte komunikimi i drejtpërdrejtë me udhëheqësit e Luginës së Preshevës, konkretisht Komunës së Bujanocit. Planifikojmë që kësi takime të kemi edhe me përfaqësuesit e Komunës së Preshevës. Pra, qëllimi ynë është të diskutojmë për situatën aktuale atje, për kërkesat dhe nevojat e shqiptarëve në Luginë. Gjithashtu, si përfaqësues të opozitës në Kosovë dëshirojmë që drejtpërdrejt t'ua shprehim qëndrimet tona për fazën përmbyllëse të dialogut Kosovë - Serbi. Natyrisht se për ne është shumë i rëndësishëm që ky komunikim të jetë i drejtpërdrejtë, i hapur, pa asnjë paragjykim. Është në interesin e të gjithë qytetarëve të Kosovës përmirësimi dhe avancimi i gjendjes së shqiptarëve të Luginës. Natyrisht se është e domosdoshme që kërkesat e tyre, të cilat janë të vlefshme dhe në përputhje me standardet evropiane, të jenë të përfaqësuara si duhet në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, pra

# ë drejtat e serbëve të Kosovës



kur vjen çështja te të drejtat e pakicave. Në këtë drejtim duhet të kërkohet reciprociteti në raport me këto të drejta.

**"Epoka e re":** *Së fundi kanë ndryshuar kërkesat e shqiptarëve të Luginës së Preshevës në raport me Kosovën. Nga reciprociteti në të drejta, tani ata po kërkojnë që përmes idesë së presidentit Thaçi për korrigjim të kufirit të bëhen pjesë e Kosovës. E keni diskutuar këtë çështje?*

**Kusari-Lila:** E diskutuam edhe qëndrim tonë të deklaruar edhe më herët. Ndryshimi i kufijve të Kosovë do të jetë në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Për të ndodhur një gjë e tillë do të duhej një proces komplet tjetër. Gjithashtu, presidenti Thaçi nuk e ka mandatin e Kuvendit të dialogojë në Bruksel në emër të Kosovës dhe as nuk ka platformë për dialog. Ajo çfarë thotë presidenti është jashtë reales. Është thënë edhe prej faktorëve ndërkombëtarë se një formë e tillë e ndryshimit të kufijve apo bashkimit të tri komunave të Luginës me Kosovën është e pamundur. Prandaj, është mirë që ne të shikojmë atë që është reale dhe cila është baza e mundësisë së përmirësimi të kushteve të shqiptarëve të Luginës së Preshevës. Natyrisht se duhet të thuhet se ajo çfarë pretendohet të bëhet në forma të jashtëligjshme dhe jashtë Kushtetutës nuk është legjitime.

**"Epoka e re":** *Në takimin e fundit që përfaqësuesit e Luginës së Preshevës kanë pasur me presidentin Thaçi, kanë kërkuar nga Kuvendi i Kosovës që me anë të një rezolute të kërkohet bashkimi i tri komunave me Kosovën. Cili është qëndrimi Alternativës rreth kësaj kërkese?*

**Kusari-Lila:** Qëndrimi i Alternativës është se Kuvendi i Kosovës duhet sa më parë të miratojë një rezolutë e cila do t'i përfshijë shtyllat e dialogut për fazën finale me Serbinë. Një ndër pikat e kësaj rezolute duhet të jetë reciprociteti i të drejtave si bazë e marrëveshjes në mes të Kosovës dhe Serbisë. Domethënë, ajo që garantohet për pakicën serbe në Kosovë të garantohet edhe për pakicën shqiptare në Republikën e Serbisë. Konsideroj se kjo shkon përtej vijave politike ditore, përtej qëndrimeve pozitë dhe opozitë, sepse kjo është në interes kombëtar. Është koha e fundit që shqiptarët e Luginës të jenë të përfaqësuar dinjitetshëm dhe natyrisht të mos bëhen manipulime dhe pazare në emër të tyre, pastaj të shkaktohen pasoja të parikuperueshme. Të gjithë e dimë se një rezolutë e cila do ta parashihte bashkimin e tri komunave të Luginës së Preshevës me Kosovën do të jetë me pasoja më të rënda për shqiptarët e asaj ane. Kjo mund të rezultojë me shpopullim, me migrim masiv dhe me represione të tjera të shtetit serb ndaj tyre.

**"Epoka e re":** *I bie kjo se do të kemi harmonizim të rezolutës së opozitës për dialog me kërkesat e shqiptarëve të Luginës për bashkim me Kosovën?*

**Kusari-Lila:** Alternativa do të insistojë që të arrihet konsensusi kombëtar midis pozitës dhe opozitës për këto çështje: së pari, për mosndryshimin e kufijve të Kosovës; së dyti, për përcaktimin e objektivave të qarta në platformën e bisedimeve në Bruksel; së treti, për mandatimin e ekipit negociues në Bruksel. Të tri këto çështje duhet të ngrihen përmbi politikën ditore, përmbi pozicionet aktuale të partive politike, sepse kjo ka të bëjë me interesin kombëtar. Ajo çfarë mund të themi është se mbetemi prapa kërkesës së vazhdueshme se rezoluta e opozitës për mosndryshim të kufijve të kalojë duke marrë edhe votat e partive në pushtet, gjithashtu Kuvendi sa më parë duhet ta miratojë platformën për bisedimet në Bruksel dhe ekipin negociator pa presidentin Thaçi.

**"Epoka e re":** *Pikërisht tek nxjerrja e rezolutës së opozitës dhe te propozimi i Qeverisë për ekip negociator ka ngecur vendimmarrja e Kuvendit, ku asnjëra palë nuk po mund të ketë kuorum për të ecur përpara. Si mund të arrihet deri te zgjidhja?*

**Kusari-Lila:** Zgjidhja është që partitë e pozitës dhe të opozitës të pajtohen për disa çështje kombëtare. Pika e parë e rëndësisë kombëtare është mosndryshimi i kufijve të Kosovës. Pika e dytë është votimi i platformës së përbashkët për bisedime me Serbinë. Pika e tretë është miratimi i ekipit negociator. Këto tri çështje domosdoshmërisht duhet të pajtohen dhe të jenë pjesë e miratimit të partive shqiptare në Kuvendin e Kosovës.

**"Epoka e re":** *Qeveria tashmë e ka propozuar ekipin negociator. A mund të pritet që pjesë e tij të bëhet Alternativa dhe pjesa tjetër e opozitës?*

**Kusari-Lila:** Konsiderojmë se primar është votimi i rezolutës për mosndryshim të kufijve të Kosovës. Kjo është pika kryesore. Para delegacionit duhet të miratohet platforma për bisedime, pastaj në fund duhet të vijë delegacioni. Nuk mund të mandatohet një delegacion nëse nuk kalon platforma e qartë për bisedime me Serbinë në Kuvendin e Kosovës. Më pak e rëndësishme është përbërja e delegacionit. Shumë më rëndësi ka platforma në bazë të së cilës do të negociohet me Serbinë. Kuvendi i Kosovës, si organi më i lartë në vend, duhet t'i përcaktojë objektivat dhe rrugën e negociatave në Bruksel me Serbinë.

# Parlamenti Evropian voton sot rreth liberalizimit të vizave për Kosovën

PRISHTINË, 12 SHTATOR - Parlamenti Evropian (PE) do ta votojë sot (e enjte) rekomandimin për liberalizimin e vizave për Kosovën, ka bërë me dije nëpërmjet një njoftimi Komiteti për Liritë Qytetare, Drejtësi dhe Çështje të Brendshme (LIBE) i Parlamentit Evropian. Pas këtij votimi do të konfirmohet mandati për fillimin e bisedimeve me vendet anëtare të BE-së, në mënyrë që Kosovës t'i liberalizohen vizat.

Bisedimet në emër të Parlamentit Evropian do t'i udhëheqë Tanja Fajon, raportuese e Kosovës për vizat në PE.

Votimi në Parlamentin Evropian ishte paraparë për muajt e ardhshëm por, sipas njoftimit të komitetit LIBE, "disa grupe parlamentare kanë kërkuar që votimi të ndodhë në sesionin e shtatorit".

Për liberalizimin e vizave është e domosdoshme që pajtimin ta japin edhe dy institucione kyçe të BE-së: Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Ministrave, ku bëjnë pjesë ministrat e brendshëm të vendeve anëtare.

Të enjten kur raportuesja për vizat e merr mandatin për fillimin e bisedimeve me Këshillin e Bashkimit Evropian, procesi kalon në nivelin e grupeve punuese.

Radio Evropa e Lirë" mëson se takimi i parë i grupit punues do të mbahet më 17 shtator. Pasi të përafrohen bisedimet në kuadër të grupit punues, çështja kalon në nivel të ministrave të Brendshëm të Bashkimit Evropian, të cilët vendosin për këtë nëpërmjet votimit me një shumicë të kualifikuar.

Komisioni Evropian më 18 korrik të këtij viti vendosi se Kosova i ka përmbushur të gjitha kriteret dhe i rekomandoi Bashkimi Evropian t'i liberalizojë vizat për qytetarët e Kosovës.

Kosova është vendi i vetëm në Ballkanin Perëndimor, qytetarët e së cilës nuk gëzojnë të drejtën e lëvizjes së lirë në Zonën e Shengenit.



# Opozita i shkruan letër Mogherinit rreth fazës së fundit të dialogut

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) së bashku me Lëvizjen Vetëvendosje, PSD-në dhe Alternativën i kanë dërguar një letër përfaqësueses së lartë të Bashkimit Evropian, Federica Mogherini, lidhur me dialogun Kosovë - Serbi




EPOKA E RE Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 12 SHTATOR - Letra që i është përcjell përfaqësueses së lartë të Bashkimit Evropian, Federica Mogherini, mban nënshkrimin e përfaqësuesve të katër partive opozitare: LDK-së, LV-së, PS-së dhe Alternativës. Përmes kësaj letre këto parti opozitare kanë shprehur pakënaqësinë e tyre lidhur me idenë që po diskutohet për shkëmbim të territoreve apo korrigjim të kufijve. "Këto ide nuk do të kenë mbështetje dhe çfarëdo marrëveshje e cila derivon nga ide të tilla nuk do të përkrahet", është thënë në njoftimin e LDK-së.
Katër partitë opozitare përmes kësaj letre kanë kërkuar që faza finale e dialogut me Serbinë të bazohet në parime të qarta si dhe në një kornizë të qartë, duke mos lënë anash subjektivitetin shtetëror të Kosovës i cili është përcaktuar me Deklaratën e Pavarësisë, opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë dhe faktin se Kosova është pranuar nga shumica e kombeve të lira të botës. "Fillimi i një procesi të ri të dialogut pa përgatitjet e nevojshme, siç po tenton qeveria aktuale, do të dështojë. Është përgjegjësi e plotë e Kuvendit të Kosovës që ta aprovojë platformën për dialog me një shumicë prej 2/3 dhe vetëm në këtë formë mund të sigurohet legjitimitet i këtij procesi. Çdo formë tjetër e zhvillimit të dialogut është e destinuar të dështojë. Është në interesin e qytetarëve të Kosovës të arrihet një konsensus i tillë brenda Kuvendit të Kosovës", është theksuar në njoftimin e LDK-së.
Po në këtë njoftim është thënë se Qeveria aktuale ka humbur legjitimitetin për ta përfaqësuar Kosovën në këtë proces dhe se një legjitimim i ri i Kuvendit të Kosovës duhet të ndodhë sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës. "Duke vlerësuar lart rolin e Bashkimit Evropian në këtë proces dhe përkrahjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, partitë opozitare të Kuvendit të Kosovës besojnë se të dyja duhet të jenë plotësisht të përfshira dhe të kërkojnë që marrëveshja përfundimtare me Serbinë të nënkuptojë normalizim të plotë të marrëdhënieve në mes të dy shteteve. Normalizimi i plotë mund të arrihet vetëm me njohje reciproke. Marrëveshja përfundimtare me Serbinë duhet t'i mundësojë Kosovës anëtarësim të menjëhershëm në organizatat ndërkombëtare, para së gjithash në OKB, si dhe t'i hapë rrugë anëtarësimit në BE dhe NATO", është thënë në njoftimin e LDK-së.

# Ministri Berisha: Kosova po koordinohet me NATO-n rreth transformimit të FSK-së



Kosova do të jetë plotësisht transparente në mënyrë që vendimet rreth transformimit të FSK-së dhe të ardhmes së saj mos ta befasojnë askënd.

PRISHTINË, 12 SHTATOR (ER) - Ministri i Forcës së Sigurisë të Kosovës, Rrustem Berisha, ka bërë me dije të mërkurën se shteti i Kosovës dhe ministria që drejton në vazhdimësi është duke u koordinuar me NATO-n, shtetet partnere dhe partnerët strategjikë rreth planit të Kosovës për të ardhmen e FSK-së. Ai ka thënë se Kosova do të jetë plotësisht transparente në mënyrë që vendimet rreth transformimit të FSK-së dhe të ardhmes së saj mos ta befasojnë askënd. Këtë deklaratë ministri i FSK-së e dha gjatë takimit që pati me ambasadoren e Finlandës në Republikën e Kosovës, Pia Stjernvall. Në këtë takim të përbashkët u bisedua për marrëdhëniet e shkëlqyera ndërshtetërore në mes të Kosovës dhe Finlandës, në veçanti për nevojën e inicimit të një bashkëpunimi në mes të Kosovës dhe Finlandës në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes, përkatësisht në mes të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Finlandës.

## Musliu: Komisioni ka vullnet për shkarkimin e inspektorit të përgjithshëm të AKI-së

Prishtinë, 12 shtator - Anëtarët e Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë kanë vullnet për të kërkuar shkarkimin e inspektorit të përgjithshëm të AKI-së, Shkëlzen Sopjani, pas vrasjes që ndodhi në këtë institucion javën që shkoi. Këtë e ka konfirmuar nënkryetarja e këtij komisioni, Ganimete Musliu, pas raportimit të inspektorit Sopjani të mërkurën para anëtarëve të këtij komisioni. Sipas saj, Komisioni për Mbikëqyrjen e AKI-së është i vendosur të kërkojë llogari të plotë nga përgjegjësit e rastit për vrasjen e ndodhur ditë më parë brenda këtij institucioni.
Javën e ardhshme para këtij komisioni është ftuar të raportojë për këtë vrasje, drejtori i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, Shpend Maxhuni. Deputetja Musliu ka konfirmuar se arma e përdorur për vrasje ka qenë pa leje. (ksp)



# ‘Çohu’: Financimi i partive politike, proces i pakontrolluar

Mënyra e financimit të partive politike në Kosovë që nga krijimi i institucioneve është përcjell me probleme dhe defekte të shumta, të cilat kanë bërë që ky proces të mbetet i pakontrolluar dhe menaxhuar siç duhet. Kështu kanë deklaruar përfaqësuesit e Organizatës "Çohu" në një konferencë me gazetarë, në të cilën kanë publikuar videografin mbi financimin e subjekteve politike




EPOKA E RE Faton DËRMAKU

Prishtinë, 12 shtator - Përfaqësuesit e organizatës "Çohu" të mërkurën kanë mbajtur një konferencë për media, në të cilën kanë prezantuar videografin mbi financimin e partive politike. Po në këtë konferencë është folur edhe mbi krijimin e raporteve klienteliste mes bizneseve dhe partive politike.

Artan Demhasaj nga "Çohu" ka thënë se mënyra e financimit të partive politike në Kosovë që nga krijimi i institucioneve është përcjell me probleme të shumta, të cilat kanë bërë që ky proces të mbetet i pakontrolluar dhe menaxhuar siç duhet. "Financimi, edhe pse i rregulluar me ligjin e vitit 2010, i ndryshuar e plotësuar në vitin 2012 dhe 2013, tregon shumë probleme dhe zbrazëtira juridike që po e bëjnë këtë ligj të paimplementueshëm dhe të pasuksesshëm për rregullimin e financimit të partive politike", ka thënë Demhasaj.

Duke pasur parasysh se në këtë kohë janë duke u diskutuar ndryshimet në Ligjin për financimin e partive politike, "Çohu" ka adresuar problemet ekzistuese lidhur me këtë proces. Demhasaj ka thënë se, pavarësisht se struktura ligjore përcakton një model të caktuar të financimit, njeh kategoritë e mundshme të financimit dhe përcakton edhe masa disiplinore kundrejt mungesës së transparencës, Ligji për financimin e subjekteve politike mbetet ndër ligjet më të pazbatuar në nivel vendi. "Gjatë hulumtimeve të mëhershme të organizatës 'Çohu' kemi gjetur se kjo mënyrë e rregullimit të financimit të subjekteve politike ka krijuar hapësirë për krijimin e raporteve klienteliste në mes të subjekteve politike dhe bizneseve. Edhe pse ligji në disa raste ka paraparë masa të kontrollit për parandalimin e raporteve klienteliste, në raportet e auditorit asnjëherë nuk përmenden si të gjetura. Në raportet e auditorit për subjektet politike për vitet 2013-2016 të publikuara nga KQZ-ja, vërehet tendenca e njëjtë e financimit nga donacionet e jashtme. Përveç që në raportet e reja disa prej subjekteve politike deklarojnë vlera të mëdha të donacioneve në kontribute për mallra dhe shërbime, por këto donacione janë të deklaruara në mënyrë shumë të paqartë", ka thënë ai.

Ai ka shtuar se në raportet e para të publikuara nga KQZ-ja nuk ishin të paraqitur numrat personalë të personave që kanë dhënë donacione për partitë politike, që ka bërë të pamundur për "Çohu"-n t'i identifikojë donatorët dhe t'i hulumtojë lidhjet e tyre me bizneset për vitet e fundit. Tanimë KQZ-ja ka publikuar si të korrigjuara këto raporte, ku gjenden edhe numrat personalë.

Demhasaj ka theksuar se organizata "Çohu" do ta vazhdojë identifikimin e lidhjeve klienteliste në raportet donator-parti edhe për këto vite. "Meqenëse masat e deritanishme ligjore nuk kanë parandaluar raportet e mundshme klienteliste në mes të subjekteve politike dhe bizneseve, 'Çohu' konsideron se është e domosdoshme që financimi nga subjektet juridike, të cilat kanë marrëdhënie kontraktuale me institucione publike, të ndalohet plotësisht", ka thënë ai.

"Çohu" konsideron se shpenzimet individuale të kandidatëve duhet të deklarohen në pasqyrat financiare të subjekteve politike.

Videografi i publikuar të mërkurën nga organizata "Çohu" paraqet në mënyrë vizuale raportet klienteliste që kanë lindur si pasojë e moskontrollimit të financave të partive politike. Përmes këtij videografi janë publikuar shumat e mjeteve financiare që secila parti politike ka pranuar nga biznese të ndryshme, si dhe numrin dhe vlerën totale të tenderëve që këto biznese i kanë marrë përmes procedurave të prokurimit publik.

# Menduh Thaçi: Besojmë në rezultat pozitiv të referendumit



Prishtinë, 12 shtator (ER) - "Nëse ka një temë që na bashkon sot kudo që jemi ne shqiptarët, si në trojet tona etnike, në Maqedoni, në diasporë dhe kudo që jemi, është vota po për referendumin në Maqedoni, për një Maqedoni në NATO, për shqiptarët në NATO", ka thënë të mërkurën kryeministri Ramush Haradinaj gjatë takimit me kryetarin e Partisë Demokratike Shqiptare në Maqedoni, Menduh Thaçi.

Kryeministri Haradinaj, pas takimit me kryetarin Thaçi, në një prononcim për media ka treguar se në këtë takim është biseduar edhe për proceset nëpër të cilat po kalojnë Kosova dhe Maqedonia, me theks çështjen e referendumit të 30 shtatorit. "Ne në Kosovë vërtet i thërrasim prej zemrës vëllezërit dhe motrat tona që jetojnë në Maqedoni, shqiptarët, të votojnë pro NATO-s, duke e ditur se NATO na e ka shpëtuar jetën në vitin 1999, në kohën tonë më të vështirë", ka thënë Haradinaj, duke vlerësuar marrëdhëniet e mira me Qeverinë e Maqedonisë, me kryeministrin Zaev, por edhe me spektrin politik dhe me politikën shqiptare atje.

Kryeministri Haradinaj dhe Menduh Thaçi u pajtuan që stabiliteti politik dhe ekonomik është i domosdoshëm për të dy vendet në mënyrë që rruga euroatlantike të jetë më e lehtë.

Kryetari i Partisë Demokratike Shqiptare, Menduh Thaçi, ka thënë se çështja kryesore e biseduar në takim me kryeministrin Haradinaj ishte referendumi i 30 shtatorit që do të mbahet në Maqedoni, një moment vërtet historik për shqiptarët e Maqedonisë. "Gjithë forcat politike shqiptare jemi duke punuar dhe besojmë plotësisht në një rezultat jashtëzakonisht pozitiv. Besojmë se gjithë shqiptarët e ndajnë bindjen me ne, se ne i kemi borxh perëndimit, i kemi borxh NATO-s dhe besoj se kjo është ideja madhore që i bashkon të gjithë shqiptarët për shkak se këtu nuk ka dilema. Orientimi ynë i përgjithshëm, pa marrë parasysh ku jetojmë si shtet, është NATO dhe BE-ja", ka thënë kryetari Thaçi.

# Ambasada Amerikane vlerëson punën e KEK-ut

EPOKA E RE A. MAVRAJ

PRISHTINË, 12 SHTATOR - Një delegacion i lartë nga Ambasada Amerikane në Prishtinë, në krye me Jessica Long, udhëheqëse e Sektorit Ekonomik dhe Politik dhe Lori Michaelson, udhëheqëse e Njësisë Ekonomike, kanë vizituar të mërkurën Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK).

Drejtori menaxhues i KEK-ut, Njazi Thaçi, i ka informuar mysafirët për gjendjen aktuale në korporatë, për rezultatet e arritura, si dhe për sfidat dhe proceset nëpër të cilat po kalon KEK-u, me theks të veçantë për zhvillimet e fundit rreth zgjerimit të minierave të reja dhe procesin e shpronësimeve. Gjithashtu, ka njoftuar edhe për kapacitetet prodhuese dhe strategjitë e KEK-ut në gjenerim të thëngjillit dhe prodhim të energjisë elektrike.

Gjatë vizitës në Termocentralet "Kosovën A" dhe "Kosova B" përfaqësueset e Ambasadës Amerikane janë njoftuar me punët të cilat janë duke u bërë dhe rezultatet të cilat janë arritur në stabilitetin e prodhimit të energjisë pavarësisht prej vjetërsisë së termocentraleve. "KEK-u në vazhdimësi ka performuar jashtëzakonisht mirë. Edhe krahasuar me statistikat e vitit 1985 kur kanë qenë të reja këto blloqe nuk kanë qenë me stabile se tani. Në atë kohë kur kanë filluar punën, sipas statistikave, kanë pasur rreth 100 rënie të paplanifikuara, ndërsa sot në vitin 2018 numri i rënieve të paplanifikuar nuk shkon mbi 30", ka thënë drejtori menaxhues i KEK-ut, Njazi Thaçi.

Gjatë vizitës në miniera, Thaçi i ka njoftuar edhe me procesin e shpronësimeve, zgjerimin e mihjeve të reja dhe zhvendosjen.

Ndërsa zyrtarët e delegacionit të Ambasadës Amerikane në Prishtinë theksuan se siguria e energjisë është një problem i madh për Kosovën, që i kushton ekonomisë së Kosovës më shumë se 400 milionë dollarë në vit. Ata vlerësuan përpjekjet e KEK-ut për ta përmirësuar besueshmërinë e termocentraleve dhe për ta siguruar furnizimin me thëngjill, dhe shtuan se marrëveshja e termocentralit Kosova e Re është një hap i madh në rrugën e vendit drejt sigurisë energjetike.



# Kosova dhe Gjermania nënshkruajnë marrëveshjen për bashkëpunim zhvillimor



PRISHTINË, 12 SHTATOR (ER) - Qeveria e Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga ministri i Financave, Bedri Hamza dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, e përfaqësuar nga ambasadori gjerman në Kosovë, Christian Heldt, kanë nënshkruar të mërkurën marrëveshjen e parë për bashkëpunim zhvillimor.

Sipas komunikatës së lëshuar nga Ambasada e Gjermanisë në Kosovë, kjo marrëveshje rregullon bazën e bashkëpunimit teknik dhe financiar mes të dyja vendeve. Gjatë ceremonisë së nënshkrimit ministri Hamza ka thënë se arritja e kësaj marrëveshje me shtetin gjerman është tejet e rëndësishme për Kosovën, marrë parasysh se që nga paslufta shteti gjerman ka qenë i pranishëm në Kosovë përmes asistencës teknike dhe financiare me mbi 600 milionë euro.

Ai ka treguar se në kuadër të këtij bashkëpunimi janë realizuar projekte në sektorë tejet të rëndësishëm për shtetin e Kosovës, siç janë ai i ujërave, i energjisë, i mjedisit, si dhe nëpërmjet asistencës së ofruar për zhvillim të institucioneve të vendit. "Kualiteti i jetës së qytetarëve nuk do të ishte i tillë pa vlerën që i ka shtuar bashkëpunimi me qeverinë gjermane", ka deklaruar Hamza.

Ndërsa ambasadori Heldt në fjalimin e tij, ndër të tjera, ka theksuar rëndësinë e marrëveshjes si bazë për një bashkëpunim edhe më efikas në mes të dyja vendeve gjatë caktimit të projekteve zhvillimore.

## Kosova prezanton kapacitetet e ekonomisë digjitale në panairin DMEXCO 2018

KOLN, 12 SHTATOR (ER) - Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë po prezanton Republikën e Kosovës në ngjarjen më të madhe të ekonomisë digjitale, marketingut dhe inovacionit DMEXCO 2018, që po mbahet në Koln të Gjermanisë, vend ky ku takohen liderët botërorë të ekonomisë digjitale, marketingut dhe inovacionit.

Pjesëmarrja e Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, me përfaqësuesit e saj, po bëhet me kërkesë të komunitetit të ekonomisë digjitale dhe në pajtim me Programin e Qeverisë dhe Planin e Punës së Ministrisë për vitin 2018.

Në komunikatën për medie të lëshuar nga kjo ministri është thënë se përmes këtij panairi po synohet ndërkombëtarizimi i ekonomisë së Kosovës, thithja e investimeve të huaja, ndërtimi i urave të bashkëpunimit në mes të komunitetit tonë dhe bashkëpunëtorëve të huaj, si dhe promovimi i Republikës së Kosovës dhe inkuadrimi në zinxhirët e vlerave ndërkombëtare të ekonomisë.



# Hoxha thotë se punëtorët e Postës kanë mbetur pa paga shkaku i Qeverisë

Kryeshefi ekzekutiv i Postës së Kosovës, Sejdi Hoxha, ka mbajtur të mërkurën konferencë të jashtëzakonshme për media, në të cilën ka folur për situatën në të cilën ndodhet Posta dhe punëtorët e saj




EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 12 SHTATOR - Kryeshefi ekzekutiv i Postës së Kosovës, Sejdi Hoxha, ka deklaruar se greva nga punonjësit e Postës së Kosovës është duke vazhduar për shkak të mosekzekutimit të pagave shkaku i pasojës së mospagesës së pesë milionë eurove të humbjeve nga shërbimi universal postar prej Qeverisë së Kosovës. "Qe dy ditë jemi në situatë më të jashtëzakonshme si pasojë e mosekzekutimit të pagave. Ne sot ju kemi thirrur ta sqarojmë problemin. Në mars kemi thënë se nëse nuk kryhet pagesa e humbjeve të shërbimit universal postar nga Qeveria ne nuk do të mund t'i ekzekutojmë pagat. Ky moment ka ardhur", ka deklaruar Hoxha.

Ai ka thënë se Posta e Kosovës e ka çuar rastin tek përmbaruesi privatë e më pas edhe në Gjykatën Themelore dhe të dyja e kanë obliguar Qeverinë t'i paguajë humbjet. "Pas kësaj, çështja ka shkuar edhe në Gjykatën Themelore, e cila ka marrë vendim dhe i ka dhënë të drejtë Postës së Kosovës, që Qeveria ta bëjë mbulimin e shërbimit universal postar", ka thënë Hoxha. Ai ka treguar se borxhi aktual i Postës së Kosovës është rreth pesë milionë euro. Sipas tij, vetëm Telekomi i Kosovës i ka borxh Postës rreth 350 mijë euro. Kurse rreth katër milionë euro është thënë se janë humbje nga shërbimi universal postar. "Ne me 0.40 cent ofrojmë një dërgesë postare nga Prishtina në Dragash. Postën e obligon ligji ta përfundojë këtë shërbim, por i njëjti ligj e obligon edhe Qeverinë e Kosovës t'i mbulojë humbjet nga shërbimi universal postar", është shprehur Hoxha.



Ai ka thënë se i gjithë dokumentacioni i nevojshëm dhe kriteret ligjore deri më tani janë plotësuar dhe janë adresuar në Qeveri për mbulimin e humbjeve. "I gjithë dokumentacioni ka shkuar në Qeverinë e Kosovës dhe tashmë po presim që Qeveria të reflektojë, mos të mbesin punëtorët pa paga, si e drejtë e tyre themelore. Mos të kemi bllokada për bërjen e punës në formë normale, sepse çdo situatë e tillë krijon një klimë jo të mirë në ndërmarrje, një imazh jo të mirë për ndërmarrje. Dhe, e dëmton edhe afarizmin tonë për të ardhmen, pasi kemi krijuar qindra shërbime të reja në zyrat tona postare dhe nuk është e lehtë të përballemi me greva të tilla", ka theksuar Hoxha. Ai është shprehur se Posta e Kosovës është e vetmja ndërmarrje e cila ka planin konkret se si duhet të dilet nga kriza. Ai ka potencuar se një nga problemet që e privon Postën e Kosovës ta bëjë punën e saj është edhe shpërndarja e faturave të shërbimeve publike nga KEDS-i, kompanitë e ujësjellësit dhe ato të mbeturinave e jo nga Posta e Kosovës.

Sipas Hoxhës, këto kompani shkelin të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale të konsumatorëve dhe i shkaktojnë humbje Postës së Kosovës mbi 400 mijë euro në muaj. "Kostoja totale prej së cilës Posta po privohet nga e drejta për ta kryer këtë punë është 450 mijë euro në muaj. Posta po privohet ta kryejë këtë shërbim postar. Kjo e drejtë me ligj i takon Postës së Kosovës", është shprehur ai.

Hoxha ka treguar se i janë drejtuar me një shkresë Qeverisë dhe ministrive përkatëse, që faturat të dërgohen përmes postës. "Në vendet e rajonit, në Maqedoni, Serbi, Shqipëri dhe vendet e tjera evropiane dhe botërore, faturat e shërbimeve publike shpërndahen nga shërbimi postar. Pra, mbi 400 mijë euro janë në muaj humbje për shkak se faturat e shërbimeve publike shpërndahen nga kompanitë që nuk janë të licencuara. Faturat e shërbimeve publike duhet të shkojnë të zarfuara", ka deklaruar Hoxha.

Në këtë konferencë për medie ai është pyetur edhe për numrin e punësimeve në Postën e Kosovës në kohën kur në këtë institucion ka krizë financiare. Hoxha ka thënë: "Jo, s'ka pasur punësime. 21 punonjës kanë dalë në pension e ne s'i kemi zëvendësuar ata", është shprehur Hoxha.

# Matoshi nxjerr udhëzim administrativ për mbikëqyrësit e zonave të mbrojtura

PRISHTINË, 12 SHTATOR (ER) - Mbikëqyrësit e Zonave të Mbrojtura në Kosovë nga dita e mërkurë do t'i nënshtrohen provimit profesional për ta fituar të drejtën e ushtrimit të detyrave të punës së tyre. Kjo çështje është rregulluar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor përmes një udhëzimi administrativ për përmbajtjen dhe mënyrën e dhënies së provimit profesional për mbikëqyrësit e zonave të mbrojtura e që është nënshkruar nga ushtruesi i detyrës së ministrit të MMPH-së, Fatmir Matoshi.

Ky udhëzim administrativ, sipas ministrit Matoshi, ka për qëllim ta rregullojë mënyrën më efikase të menaxhimit me zonat e mbrojtura dhe ngritjen e kapaciteteve të stafit të këtyre zonave të mbrojtura. Ai ka treguar se ky udhëzim do të ndikojë në kompletimin e infrastrukturës ligjore për mbrojtjen e natyrës dhe do të jetë bazë për parandalimin dhe zbutjen e ndikimeve negative në zonat e mbrojtura si dhe për ruajtjen e larmisë biologjike dhe peizazhore dhe mbrojtjen e vlerave të natyrës.

Udhëzimi administrativ përbëhet prej gjithsejtë 12 neneve dhe përmban shtojca përcjellëse, si: temat profesionale për nënshtrim e provimit profesional, aplikacion për nënshtrim të provimit profesional për mbikëqyrës dhe certifikata mbi dhënien e provimit profesional të mbikëqyrësit.



# Prokuroria Themelore në Prizren, e hapur për takime me qytetarë

PRIZREN, 12 SHTATOR (ER) - Prokuroria Themelore në Prizren vazhdon t'i mbajë takimet e hapura me qytetarë të cilët shprehin interes të takohen me kryeprokurorin e kësaj prokurorie, Admir Shala.
Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, në vazhdën e takimeve të ndryshme javore, ditën e mërkurë, nga ora 13:00 - 15:00, e ka të caktuar për takime me qytetarë në zyrën e vet, për të gjitha palët e interesuara. Në takimet me qytetarë kryeprokurori Shala ka biseduar për çështje dhe kërkesa të ndryshme, duke u nisur nga kërkesat dhe interesimet për lëndë individuale, e deri tek rastet kur qytetarët shprehin bashkëpunimin për ta informuar kryeprokurorin për kryes dhe vepra të mundshme penale. Të gjithë të interesuarit drejtpërdrejti nga kryeprokurori Shala janë njoftuar me çështjet për të cilat kanë shprehur interesim, duke ua dhënë sqarimet e duhura. Po ashtu, kryeprokurori i ka siguruar qytetarët dhe ka shprehur gatishmërinë për bashkëpunim të ndërsjellë për zgjidhjen e çështjeve të parashtruara, duke u ofruar mbështetjen e Prokurorisë që ai e udhëheq.
Prokuroria Themelore e Prizrenit, si institucion i pavarur me autoritet dhe përgjegjësi ligjore dhe kushtetuese, mbetet e përkushtuar për t'i jetësuar praktikat e mira që mundësojnë efikasitetin, llogaridhënie, paanshmëri dhe transparencë në punën e saj, me qëllimin e vetëm për luftimin e çfarëdo lloj natyre të kriminalitetit që bie mbi kompetencën dhe përgjegjësinë e kësaj prokurorie.





# Në Malishevë shënohet Dita e Rinisë me dhjetëra aktivitete

MALISHEVË, 12 SHTATOR (ER) - Me moton "Ne e ndërtojmë të ardhmen", në Komunën e Malishevës, zyrtari për rini, Mehdi Krasniqi, para shumë të rinjve malishevas ka bërë hapjen zyrtare të Ditës së Rinisë, 12 Shtatorin. Në këtë ditë janë zhvilluar dhjetëra aktivitete kulturore-sportive, muzikore dhe në artin pamor.
Në emër të kryetarit Ragip Begaj shefja e kabinetit, Blerta Krasniqi, iu drejtua të rinjve. "Ju keni pasur dje, sot dhe do ta keni edhe në të ardhmen mbështetjen e kryetarit Begaj dhe atë institucionale në përgjithësi për projektet që ofroni, të cilat ndikojnë në zhvillimin kulturor-sportiv si dhe në fushat e tjera, prandaj Malisheva jua ofron mundësinë të dëshmoni me përgatitjen tuaj potencialin që keni për ndryshimin pozitiv të së nesërmes", ka thënë Krasniqi.
Drejtoresha në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, Besartë Kryeziu-Ramaj, ka thënë se qëllimi i kësaj dite është t'i pranojë dhe t'i njohë përpjekjet dhe përkushtimin e të rinjve malishevas që me potencialet e tyre krijuese dhe idetë e reja do të ndikojnë në përmirësimin dhe zhvillimin e Malishevës dhe shoqërisë në përgjithësi.
Ndërkaq drejtori i Departamentit për Rini në Republikën e Kosovës, Xhevat Bajrami, ka thënë se të rinjtë e Malishevës po tregojnë vlera dhe po japin shembuj se si duhet dashur dhe punuar për Kosovën.



# FSK-ja dhe Ambasada Amerikane ndajnë pajisje mësimore për nxënësit e dy shkollave

LIPJAN, 12 SHTATOR (ER) - Forca e Sigurisë së Kosovës, në bashkëpunim me Elementin Mbështetës Civil-Ushtarak (EMCU) pranë Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikane në Kosovë, kanë ndarë donacion pajisje shkollore për nxënësit e Shkollës Fillore "Shtjefën Gjeçovi" në Janjevë të Komunës së Lipjanit dhe në Shkollën Fillore "Vesel Muja" në Ponesh të Komunës së Gjilanit.
Ky donacion është koordinuar nga EMCU (Ambasada Amerikane) dhe FSK-ja si dhe është bërë i mundur nga fondet e mbledhura nga OJQ-ja "Spirt of America".
Përfitues të këtij fondi kanë qenë 54 nxënës shqiptarë, kroatë dhe të komunitetit RAE të Shkollës Fillore "Shtjefën Gjeçovi" në Janjevë si dhe 30 nxënës të Shkollës Fillore "Vesel Muja" në Ponesh të Gjilanit.
Përmes këtyre projekteve dhe aktiviteteve dhe falë bashkëpunimit të mirë që ka FSK-ja me Ambasadën e ShBA-së në Kosovë, më saktësisht me EMCU-në, po realizojnë projekte për ndihmë qytetarëve të Kosovës pa dallime etnie.

# Hapet edhe dega e dytë e AFK-së në Pejë

PEJË, 12 SHTATOR (ER) - Të gjithë bujqit dhe bizneset e Pejës do të mund të marrin më shumë shërbime nga Agjencia për Financim në Kosovë (AFK) pasi që ky institucion mikrofinanciar ka hapur edhe degën e dytë në këtë komunë. Kjo është dega e 22-të që AFK-ja ka hapur në Kosovë.
Edmond Beqiri, anëtar i Bordit të Agjencisë së Financimit në Kosovë (AFK), ka bërë me dije se ndihen krenarë që fillimet e tyre i kanë në qytetin e Pejës, pasi kanë nisur me një portofoli prej dy milionë eurosh, ndërsa tani kanë arritur ta zgjerojnë portofolin e tyre në rreth 30 milionë euro. Po ashtu, ai ka thënë se misioni i këtij institucioni mikrofinanciar është human, për t'u dalë në ndihmë të gjithë atyre që nuk marrin përkrahje financiare nga bankat.



# QENDRA SERBO-RUSE NË NISH DHE LOJA ME 'KORRIGJIMIN' E KUFIRIT



Milazim KRASNIQI

Pas vizitës në rajon të senatorit amerikan Ron Xhonsonit, është më e qartë loja e Thaçit lidhur me "korrigjimin e kufirit", ose loja e Vuçiqit me "kufizimin ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve". Si duket e tërë loja ka të bëjë me problemin që paraqet Qendra Humanitare serbo-ruse në Nish, ku Rusia i ka futë moti hundët, ndërsa tash insiston që personeli rus në atë qendër ta marrë statusin e personelit diplomatik. Nëse Serbia ua jep këtë status, Qendra shndërrohet në celulë spiunazhi dhe aktiviteti ushtarak rus do të ketë imunitet dhe legalitet për të gjitha veprimtaritë që bën në Serbi po edhe në Ballkan.

Për shkak të rrezikut që paraqet kjo qendër ruse për interesat e ShBA-së dhe të NATO-s, ShBA-ja po ushtron presion mbi Vuçiqin që të mos ia japë imunitetin diplomatik personelit rus në atë qendër. Për këtë arsye, ShBA-ja është duke e marrë me të mirë e duke e lavdëruar shumë Vuçiqin dhe duke i bërë lëshime të mëdha në raport me Kosovën, të cilën amerikanët e konsiderojnë pronë të veten. Në këtë kontekst duhet të shihet edhe lejimi i vizitës së Vuçiqit në Gazivodë, mbyllja e veshëve të Robsonit e të administratës së ShBA-së për deklaratat e Vuçiqit, në të cilat ai e glorifikoi Millosheviqin. Por, ShBA-ja nuk ndalon vetëm në lëvdata e koncesione. Përtej tyre, ShBA-ja e ka nisur edhe një presion mbi Vuçiqin, duke kërcënuar se mund t'i merret Lugina e Preshevës, për ta mbyllur lidhjen e saj strategjike me Maqedoninë e me Greqinë. Ky presion, që në terren po shtyhet me angazhimin e Thaçit dhe të liderëve të Luginës së Preshevës, si duket është i lidhur me problemin e qendrës ushtarake ruse në Nish. Pra, kërkesa për gjoja aneksimin e Luginës së Preshevës nga Kosova duket të jetë pjesë e skenarit amerikan të presionit mbi Serbinë për ta mbyllur disi atë qendër.

Nëse Vuçiqi reziston ndaj Putinit, i cili pritet të vijë në Serbi gjatë tetorit, atëherë amerikanët mund të harrojnë "korrigjimin e kufirit" dhe të vazhdojnë politikat e deritashme. Por, nëse Serbia kapitullon para Putinit lidhur me Qendrën ushtarake në Nish, mund të aktivizohet përnjëmend skenari për mbylljen e korridorit serb në drejtim të Maqedonisë e Greqisë. Thënë shkurt, ShBA-ja është duke luajtur lojën e vet në rivalizim me Rusinë lidhur me Qendrën ruse në Nish, natyrisht për interesat e veta gjeostrategjike. Serbia e Kosova mund të jenë "dëme kolaterale" të këtij rivaliteti.

Nga ajo që sot për sot mund të kuptohet, Kosova nuk fiton asgjë nga kjo lojë dhe nga ky rivalitet gjeostrategjik ruso-amerikan. Përkundrazi, vetëm sa e rrezikon stabilitetin dhe integritetin formal territorial. Ndërsa, humbësit më të mëdhenj mund të jenë shqiptarët e Luginës së Preshevës, të cilët po keqpërdoren në këtë lojë dhe të cilët në fund do të lihen në baltë, siç u lanë në vitin 2000.

Në fakt, nëse Vuçiqi kapitullon para Putinit, duke ia dhënë imunitetin personelit rus në Qendrën në Nish, atëherë humbëse do të jetë edhe Serbia sepse do të riarmiqësohej me ShBA-në dhe me NATO-n dhe do të kishte një ngufatje strategjike në jugun e saj.

# Bytyqi: Fushë-Kosova ka nevojë për ndërtimin e shkollave të reja

Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka vizituar të mërkurën Shkollën Fillore "Mihal Grameno" në Fushë-Kosovë. Ai ka përmendur edhe situatën në këtë shkollë dhe në përgjithësi në Komunën e Fushë-Kosovës, ku nga ardhja e banorëve nga pjesë e tjera të Kosovës, është rritur shumë numri i nxënësve



**Fushë-Kosovë, 12 shtator (ER)** - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, në vazhdim të vizitave në shkollat e Kosovës, ka vizituar të mërkurën Shkollën Fillore "Mihal Grameno" në Fushë-Kosovë, ku ka bashkëbiseduar me udhëheqësit e shkollës dhe mësimdhënësit për të arriturat dhe vështirësitë që hasen gjatë zhvillimit të procesit mësimor. Me këtë rast, ministri Bytyqi ka theksuar se ky është një vit i rëndësishëm shkollor, pasi po bëhen përpjekje të mëdha për angazhimin e të gjithë aktorëve për ta lëvizur përpara sistemin e arsimit. "Nëse ne i shohim problemet që ka sistemi arsimor, që i kanë shkollat tona, si një problem të përbashkët për ta zgjidhur, besoj se jemi pikërisht në vitin kur do ta marrim një rrugë të mbarë në arsim", ka thënë ministry Bytyqi.

Ai ka përmendur edhe situatën në këtë shkollë dhe në përgjithësi në Komunën e Fushë-Kosovës, ku nga ardhja e banorëve nga pjesë e tjera të Kosovës është rritur shumë numri i nxënësve. Por, ai ka shprehur gatishmërinë për të gjetur zgjidhje në këtë situatë. "Jemi të gatshëm që të jemi në krah me ju, që të ulemi bashkë me ju, edhe me Ministrinë e Financave, që të bëjmë zgjidhje", ka thënë ministri Bytyqi, pasi ka theksuar se duhet të rritet numri i paraleleve, pra edhe i mësimdhënësve, në mënyrë që të mos kemi klasa të stërngarkuara, për pasojë edhe mungesë të cilësisë në arsim.

Ministri Bytyqi ka theksuar se Fushë-Kosova është komuna që ka nevojën më të theksuar për ndërtimin e shkollave të reja dhe për këtë tha se nevojitet angazhim i përbashkët me komunën, e cila është e obliguar ta sigurojë hapësirën dhe për këtë ka përmendur dështimin e ndërtimit të një shkolle në Fushë-Kosovë për këtë arsye.Me gjithë vështirësitë, ministri ka përgëzuar mësimdhënësit për punën që po bëjnë dhe i ka porositur që profesionin ta marrin gjithmonë si të shenjtë dhe të ofrojnë dije e kompetenca të duhura për fëmijët tanë. Në fund, ministri Bytyqi ka përmendur edhe rolin e prindërve dhe ka theksuar se ata duhet ta luajnë një rol shumë të rëndësishëm.

## Putini propozon papritur traktat të paqes me Japoninë

**Moskë, 12 shtator** - Presidenti rus, Vladimir Putin ka propozuar nënshkrimin e një traktati të paqes për Luftën e Dytë Botërore me Japoninë, deri në fund të vitit, "pa parakushte".
Putini ka bërë këtë ofertë të papritur teksa ishte ulur afër kryeministrit japonez, Shinzo Abe, në Forumin Ekonomik, që po mbahet në qytetin rus, Vladivostok më 12 shtator.
Pasi Abe i ka përmendur Putinit çështjet e traktatit dhe zgjidhje të konflikt të gjatë me dekada për një grup ishujsh, për të cilët kanë pretendime të dyja vendet, Putini ka thënë: "Një ide sapo erdhi në mendjen time". "Le të pajtohemi për një traktat të paqes para përfundimit të këtij viti, pa ndonjë parakusht", është shprehur ai, duke shtuar se çështjet e konfliktit mund të zgjidhen më vonë. Ndërkaq Abe nuk e ka komentuar propozimin.
Një traktat pa parakushte do t'i mundësonte Rusisë kontrollin e ishujve kontestues, të cilëve Rusia dhe Japonia iu referohen ndryshe.
Forcat sovjetike kanë pushtuar ishujt në fund të Luftës së Dytë Botërore, andaj mospajtimet për këtë territor kanë parandaluar Moskën dhe Tokion që t'iu japin fund edhe zyrtarisht armiqësive.



# Junckeri: Të jemi të bashkuar për Ballkanin Perëndimor

Presidenti i Komisionit Evropian, Jean Claude Juncker, gjatë fjalimit vjetor në Parlamentin Evropian tha se duhet të jemi bashkë kur flitet për Ballkanin Perëndimor, njëherë e përgjithmonë, dhe nëse nuk e bëjmë, ky rajon fqinj i afërt me ne do të formësohet nga të tjerët



**Bruksel, 12 shtator** - Presidenti i Komisionit Evropian, Jean Claude Juncker, i bëri thirrje të mërkurën Bashkimit Evropian që të jetë i bashkuar sa i përket Ballkanit Perëndimor, për t'i penguar ndërhyrjet e faktorëve të tjerë në rajon. Ai i bëri këto komente gjatë fjalimit vjetor mbi gjendjen e Bashkimit Evropian në Parlamentin Evropian. "Duhet të jemi bashkë kur flitet për Ballkanin Perëndimor, njëherë e përgjithmonë. Nëse nuk e bëjmë, atëherë ky rajon fqinj i afërt me ne do të formësohet nga të tjerët", tha presidenti Juncker.
Gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, Shqipëria, Maqedonia, Kosova, Mali i Zi, Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina, aspirojnë integrimin në Bashkimin Evropian.
Zyrtarë të lartë evropianë u kanë bërë thirrje disa herë gjatë këtij viti vendeve të rajonit që të përfitojnë nga përpjekjet e reja të Bashkimit Evropian për një qasje ndryshe ndaj rajonit të trazuar për shkak të rritjes së ndikimit rus, krizës së emigracionit, rrëshqitjes së Turqisë drejt autoritarizmit dhe synimit për ta forcuar integrimin evropian pas largimit të Britanisë vitin e ardhshëm.
Nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, Serbia dhe Mali i Zi shihen si të parat në procesin e integrimeve. Bashkimi Evropian është shprehur në favor të hapjes së bisedimeve për anëtarësim me Shqipërinë, por duke e shtyrë vendimin për qershorin e viti të ardhshëm, në pritje të përparimeve të mëtejshme të vendit, veçanërisht lidhur me reformën në drejtësi, luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Po në qershor të vitit të ardhshëm pritet hapja e negociatave me Maqedoninë, nëse ajo miraton ndryshimin e emrit të saj kushtetues në Republika e Maqedonisë Veriore, sipas marrëveshjes së arritur me Greqinë.
Kosova mbetet e fundit në proceset integruese. Në të gjitha proceset ajo përballet edhe me sfidën që paraqet fakti që edhe më tej, pesë nga 28 vendet anëtare të Bashkimit Evropian nuk e kanë njohur pavarësinë e saj që kundërshtohet nga Beogradi me të cilin Prishtina është përfshirë në një proces bisedimesh për normalizimin e marrëdhënieve - kusht për të dyja palët për integrimet evropiane.
Presidenti Juncker, tha se Komisioni do të jetë i ashpër ndaj vendeve të Bashkimit Evropian që nuk respektojnë sundimin e ligjit, mes shqetësimesh se Polonia dhe Hungaria nuk respektojnë parime demokratike të Bashkimit Evropian.
Gjatë fjalimit vjetor ai tha se neni i 7-të Bashkimit Evropian, një proces që mund të çojë në sanksione siç është pezullimi i të drejtës së votës në Këshillin Evropian, duhet të zbatohet sa herë që kërcënohet sundimi i ligjit.
Presidenti Juncker i bëri thirrje Bashkimit Evropian që t'i shtrëngojë muskujt si një fuqi botërore, duke thënë se marrëveshja që arriti me presidentin amerikan, Donald Trump, për të shmangur një luftë transatlantike tregtare nuk ishte "kurrfarë befasie", pasi ai foli në emër të një Evrope të bashkuar.
Duke vënë në dukje pikëpyetjet e shumë vendeve lidhur me rolin e Uashingtonit si udhëheqës ekonomik botëror, ish-kryeministri i Luksemburgut, mbrojti idenë që euroja duhet ta sfidojë dollarin si monedhën udhëheqëse në botë, duke e quajtur 'absurd' faktin se BE-ja paguan për shumicën e energjisë së saj në monedhë amerikane, edhe pse e ble atë kryesisht nga Rusia dhe vendet e Gjirit. Ai tha se kompanitë ajrore duhet gjithashtu të blejnë avionë në euro, e jo në dollarë.
Junckeri, i cili po hyn në vitin e fundit si president i Komisionit Evropian, tha se BE-ja duhet të ofrojë marrëveshje të tregtisë së lirë me gjithë kontinentin afrikan, dhe një aleancë investimesh. Ai propozoi forcimin e kufijve të jashtëm të Bashkimit Evropian me 10 mijë trupa për t'i penguar migruesit ekonomikë që kanë nxitur nacionalizmat kundër BE-së

## Papa takohet me udhëheqësit e Kishës Katolike

**Vatikan, 12 shtator** - Papa Françesku pritet të takohet sot (e enjte) me udhëheqësit e Kishës Katolike amerikane për të diskutuar rreth skandalit të abuzimit seksual në Shtetet e Bashkuara dhe mbulimin e akuzave të bëra ndër vite kundër qindra priftërinjve.
Takimi me Papa Françeskun vjen ndërsa ish-ambasadori i Vatikanit, Carlo Maria Vigano ka bërë thirrje që Papa të japë dorëheqjen, pas akuzave se ai ishte në dijeni vite më parë të informacioneve të besueshme se kryepeshkopi Theodore McCarrick i Uashingtonit kishte abuzuar me një adoleshent të altarit në vitet 1970 dhe priftërinj të rinj, por nuk e ballafaqoi McCarrick-un me akuzat. Në muajin korrik Papa Françesku e largoi kryepeshkopin McCarrick nga detyra e kardinalit.
Kisha Katolike amerikane është tronditur nga akuzat e bëra ndër vite se priftërinjtë kanë abuzuar me fëmijë të vegjël brenda famullive të tyre. Edhe pse ishin në dijeni të këtyre akteve udhëheqësit e lartë të kishës i kanë mbuluar shpesh ato, duke i mbrojtur priftërinjtë nga përballja me akuza penale.
Kohët e fundit, një juri e madhe në shtetin lindor të Pensilvanisë akuzoi më shumë se 300 priftërinj të famullisë së këtij shteti, për abuzim seksual me të paktën 1 mijë të rinj, përgjatë një periudhe 70-vjeçare.



# Nicki Minaj publikon këngën e re "Barbie Dreams"

"Barbie Dreams" është kënga më e diskutuar nga albumi i Nicki Minajt "Queen" dhe tashmë ka edhe videoklipin. Kënga e inspiruar nga Notorious BIG, ku përmenden shumë yje hip hopi, shfaq reperen tejet seksi. Ajo tregon asetet në stile të flokëve të papara. "Barbie Dreams" vjen pas klipeve "Chun - Li", "Bed" dhe "Ganja Burn" nga albumi "Queen" i Nicki Minajt që debutoi në vendin e dytë në Billboard 200.



# Irina Shayk, mami me kohë të plotë




Ndërkohë që Bradley Cooper është shumë i zënë me promovimin e filmit "A star to born", Irina Shayk po bën rolin e nënës me kohë të plotë. Modelja 32-vjeçare është fotografuar duke i dhënë një puthje vajzës së saj Lea De Seine. Modeluesja ruse dukej e mrekullueshme, veshur me të zeza dhe pa make-up. Lea, vajza e saj dhe Bradley Cooper, dukej mjaft e lumtur në krahët e së ëmës.



# Duan e ndjekin 18 milionë njerëz

Dua Lipa ka arritur 18 milionë ndjekës në profilin e saj në "Instagram". Këngëtarja me famë botërore ka falënderuar të gjithë ndjekësit për këtë "ndjenjë të veçantë". Dua së fundmi ka publikuar këngën më të re "Electricity" e cila për pak ditë ka marrë 11 milionë klikime në "Youtube".

# E ëma 62-vjeçare "sfidon" motrat Kardashian



Ajo është nëna e klanit Kardashian-Jenner, femrave më me pushtet në botë për sa i përket industrisë së modës. Kris Jenner tregoi të martën në Beverly Hills se ajo është një konkurrente e fortë e të bijave. 62-vjeçarja u shfaq mjaft elegante, veshur me një kostum, i cili i rrinte përkryer.

E jashtëzakonshme

# Punoi në market për tetë vjet, vodhi proshutën me vlerë mijëra dollarë



Një punonjëse marketi në Ohio është akuzuar për vjedhje pasi ka ngrënë proshutën e shtrenjtë, vlera e së cilës arrin në 9 200 dollarë. Pronarët e zbuluan vjedhjen pasi morën informacione se një punonjëse po vidhte mishin e shtrenjtë. Një zyrtar i policisë konfirmoi se punonjësja e marketit prej tetë vjetësh është arrestuar nën akuzën e vjedhjes.

FOTO E DITES



Ndriçimi nga rrufeja mbi Lumin e Drurit, Nebraska. Fotografia është realizuar nga Randy Olson, e publikuar te 'The Guardian'.

E rrallë

# Studimi shkencor: Kush bën 'selfie' ka çrregullime mendore



Sipas një studimi të zhvilluar në ShBA, 'selfie'-t nuk janë vetëm një manifestim i epokës digjitale, por një manifestim i mirëfilltë i problemeve mendore. Bërja e 'selfie'-ve tregon mungesë të vetëvlerësimit dhe boshllëqe në jetën intime. Nga Amerika vjen lajmi se 'selfie'-t janë një manifestim i problemeve mendore, të paktën sipas 'American Psychiatric Association'.

## BARSOLETA E DITËS



**Gjyqtari pyet të dëmtuarin:**
**- Thoni se i akuzuari ju qëlloi me kovë në kokë?**
**- Mu në mes.**
**- Po në kokën tuaj nuk vërehet asgjë.**
**- Ndoshta, por shikojeni kovën si është bërë!**

KINO ABC PRISHTINE

## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

**Në ora 16:00**

### "HOTEL TRANSYLVANIA; Summer Vacation" 3D

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 orë 37 min

**Rolet:** Adam Sandler, Selena Gomez, Andy Samberg, Kevin James, David Spade, Steve Buscemi, Molly Shannon, Mel Brooks, etj.

**Regjia:** Genndy Tartakovsky







**Në ora 18:00**

### "THE DARKEST MINDS"

Fantastiko-Shkencor/Triller; 1 orë 45 min

**Rolet:** Bradley Whitford, Amandla Stenberg, Mandy Moore, Gwendoline Christie, etj.

**Regjia:** Jennifer Yuh Nelson

**Në ora 20:00 dhe 22:00**

### "THE PREDATOR" 3D,

Aksion/Aventure/Horror; 1 ore 47 min

**Rolet:** Boyd Holbrook, Trevante Rhodes, Jacob Tremblay, Keegan-Michael Key, Olivia Munn, Sterling K. Brown, Alfie Allen, Thomas Jane, Augusto Aguilera, Jake Busey, etj.

**Regjia:** Shane Black




**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Shume miqësi dhe energji pozitive rreth vetes sot. Jeni ju që tërhiqni në orbitën tuaj njerëz që kanë gjithmonë mjaft optimizëm brenda tyre.



**DEMI**
Sot ju entuziazmojnë ata persona që kanë një ideal për ta ndjekur edhe një projekt ambicioz për të realizuar. Doni t'i keni pranë me çdo kusht.



**BINJAKËT**
Raporti në çift do të lëkundet sot nga disa dyshime. Nëse jeni ju ai që duhet të justifikoheni kundrejt partnerit, duhet t'i gjeni fjalët e duhura.



**GAFORRJA**
Sot po mundoheni t'i mbyllni të gjitha punët e ditës sa më shpejt. Ju pret një darkë romantike për të cilën duhet t'i bëni të gjitha përgatitjet e duhura.



**LUANI**
Dita paraqitet e rrëmujshme me mjaft situata delikate që do ta kërkojnë ndërhyrjen tuaj. Do t'i shikoni të gjitha mundësitë për të zgjidhur një çështje.



**VIRGJËRESHA**
Nuk është se do të ketë ndonjë ulje ose ngritje të madhe dita e sotme. Rutina dhe gjendja juaj disi indiferente thjesht do të lë gjithçka të kalojë.



**PESHORJA**
Një ditë interesante ku nuk keni nevojë të komunikoni fare me partnerin sepse merreni vesh në ajër të dy. Bashkëpunimi do të jetë i përkryer.



**AKREPI**
Nuk po arrini dot të finalizoni një projekt konkret që duhet ta kishit përfunduar tashmë. Nëse hasni pengesa, kërkoni ndihmën e ekspertëve.



**SHIGJETARI**
Pasioni dhe entuziazmi janë një miks i lezetshëm sot që do t'ju bëjë të provoni përvoja shumë të veçanta.



**BRICJAPI**
Megjithëse impenjimet e ditës ju mbajnë larg njëri-tjetrit, nëse në familjen tuaj ka një problem të vogël, keni treguar që jeni të gjithë të bashkuar.



**UJORI**
Sot doni të mblidheni me miqtë, por në një vend të qetë larg zhurmave të qytetit. Mjaft ta ndani mendjen dhe do t'ju bashkohen të gjithë.



**PESHQIT**
Nuk është një ditë nga ato me të mirat, por gjithsesi do të arrini t'i merrni ato gjëra që doni nga dita e sotme. Kapni çastet që ju interesojnë.




Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

| SEINAJOEN - TPS | 1 | FLAMENGO - CORINTHIANS | 2 | ELCHE - GRANADA | 2 |
|---|---|---|---|---|---|

# Flamurtarin s'ka kush që e ndal, Dritën e 'shkundë' Llapi



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 12 SHTATOR - Ka përfunduar xhiroja e katërt në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. Vazhdon të udhëheqë Flamurtari edhe pas kësaj xhiroje, me katër fitore në po kaq ndeshje të zhvilluara. "Viktima" e radhës për kryeqytetasit ishte skuadra e Lirisë, kurse derbin e ka fituar Llapi në Gjilan kundër Dritës. Fitore bindëse shënoi Trepça '89 ndaj KEK-ut, kurse edhe Feronikeli e mposhti Ferizajn. Të mërkurën ishin zhvilluar dy ndeshje të tjera të kësaj xhiroje, ku të dyja përfunduan në barazim: Ballkani - Prishtina (1-1), Drenica - Gjilani (0-0).

## Flamurtari - Liria 3-1

Flamurtari i Prishtinës është lider i Superligës edhe pas xhiros së katërt, pasi ka shënuar fitore ndaj Lirisë me rezultat 3-1. Djelmoshat e drejtuar nga Arsim Thaqi kanë treguar formë të lartë të mërkurën kur i kanë mposhtur prizrenasit me dy golat e Alban Shillovës dhe një të Ben Quansahit, kurse golin e nderit për mysafirët e ka shënuar Gentian Benishi shtatë minuta pa përfunduar ndeshja. Në xhiron e radhës Flamurtarin e pret punë e vështirë pasi i shkon skuadrës së Llapit në stadiumin "Zahir Pajaziti", kurse Liria e pret KEK-un.

## Drita - Llapi 1-2

Kampionia aktuale e elitës, Drita, vazhdon t'i zhgënjejë tifozët në këtë edicion, pasi e ka regjistruar edhe humbjen e tretë dhe mbetet në kuotën e vetëm tri pikëve prej katër xhirove të zhvilluara. Ishte skuadra e Llapit ajo që e mposhti Dritën në ndeshjen e zhvilluar në Gjilan me rezultat 1-2. Mysafirët e paralajmëruan skuadrën vendëse se kanë synime të mëdha që nga fillimi i ndeshjes, duke shënuar golin e parë pas dhjetë minutave lojë. Autor ishte Fiton Hajdari. Megjithatë, Drita u rikthye në lojë dhe e barazoi rezultatin në minutën e 37. Autor i golit ishte mesfushori Bujar Shabani. Festim Alidema (73) realizoi golin e fitores për skuadrën nga Podujeva.

## Ferizaj - Feronikeli 0-2

Zekrija Ramadani ka debutuar me fitore si trajner i Feronikelit derisa kjo e fundit e mposhti në udhëtim Ferizajn (0-2). Pas shtatë minutave Astrit Fazliu e dënon ish-skuadrën e tij, duke shënuar për 0-1. Pjesa e parë e ndeshjes u mbyll me këtë rezultat, kurse në minutën e 67 Da Silva shënoi golin e dytë dhe të fundit në ndeshje. Të dyja këto skuadra në fundjavë kanë ndeshje të vështira, pasi Ferizaj luan në kryeqytet ndaj Prishtinës dhe Feronikeli e pret Dritën e Gjilanit.

## KEK-u - Trepça '89 1-5

Fitoren më bindëse në xhiron e katërt e shënoi skuadra e Trepçës '89 e cila e mposhti KEK-un në Obiliq (1-5). Golat për mysafirët i shënuan Mircevski (17), Bujcevski (25), Vitia (45, autogol), Shoshi (84, nga penalltia) dhe Velinovi (89), kurse golin e nderit për vendësit e shënoi Berisha (69, nga penalltia). Pas katër xhirove, KEK-u mbetet pa asnjë pikë, kurse '89-shi i ka grumbulluar katër pikë.

### IPKO SUPERLIGA

| | |
|---|---|
| Flamurtari - Liria | 3-1 |
| Drita - Llapi | 1-2 |
| Ferizaj - Feronikeli | 0-2 |
| KEK-u - Trepça '89 | 1-5 |
| Ballkani - Prishtina | 1-1 |
| Drenica - Gjilani | 0-0 |

### TABELA

| | | Pikë |
|---|---|---|
| 1. Flamurtari | 4 | 12 |
| 2. Llapi | 4 | 9 |
| 3. Feronikeli | 4 | 8 |
| 4. Prishtina | 3 | 7 |
| 5. Gjilani | 3 | 7 |
| 6. Drenica | 4 | 5 |
| 7. Trepça '89 | 4 | 4 |
| 8. Ballkani | 4 | 4 |
| 9. Drita | 4 | 3 |
| 10. Liria | 4 | 3 |
| 11. Ferizaj | 4 | 3 |
| 12. KEK-u | 4 | 0 |

Në xhiron e radhës takohen: Liria-KEK-u, Llapi-Flamurtari, Feronikeli-Drita, Prishtina-Ferizaj, Gjilani-Ballkani, Trepça '89-Drenica.

## SHKURT

### Ndërroi jetë profesor Mehdi Jashari

Ka ndërruar jetë ish-dekani i Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit, Medi Jashari. Profesor Jashari ka dhënë kontribut të madh për edukimin e shumë brezave si dhe kontribuoi shumë për avancimin e hendbollit dhe sportit të Kosovës në përgjithësi. Jashari ishte edhe përzgjedhës i Përfaqësueses së Kosovës në Hendboll, derisa punoi edhe me gjeneratat e reja dhe si komisionar. "Lajm i dhimbshëm për të gjithë ne! Ka ndërruar jetë ish-dekani i FEFS, profesori dhe pedagogu i njohur, prof. Mehdi Jashari. Në emër të Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit i shpreh ngushëllime familjes dhe komunitetit sportiv. Lamtumirë, profesor! U prefsh në paqe!", ka shkruar në "Facebook", Musa Selimi, dekan aktual i FEFS-së.

### Duka: Panuccit duhet t'i japim kohë

Christian Panucci nuk është në diskutim si trajneri i Shqipërisë. Këtë gjë e ka konfirmuar publikisht presidenti i Federatës Shqiptare të Futbollit, Armand Duka, i cili e ka rikonfirmuar trajnerin, duke i dalë krahë pas humbjes në Gllasgou, nëpërmjet një postimi në profilin e vet në "Facebook". Fakti që kuqezinjtë janë me pikë të barabarta në këtë aktivitet bashkë me Skocinë i jep bindjen atij që jemi të barabartë dhe se nuk duhet parë si tragjedi humbja e fundit. "Jemi në gjysmë të rrugës, me pikë të barabarta me rivalin. Na pret në tetor një transferim i vështirë në Izrael. Të gjithë ne duhet t'ia japim kohën e mjaftueshme trajnerit për t'i bërë ndryshimet dhe reflektimet e duhura në skuadër. Koha e llogoreve nuk vlen për askënd. Kritikat janë normale për një skuadër kur ajo humbet. Por, kur këto bëhen për interesa josportive. Nuk i shërbejnë askujt", ka shkruar Duka.

### Mediumi serb reagon pas "shqiponjës" së Ramosit

Kapiteni i Spanjës, Sergio Ramos, e ka festuar golin ndaj Kroacisë me simbolin e shqiponjës. Ramosi e shënoi golin e pestë për "Furinë e Kuqe" në minutën e 57, pastaj festoi në stilin e Granit Xhakës dhe Xherdan Shaqirit. Dhe pas kësaj, ka reaguar mediumi serb i cili shkruan se Ramosi festoi në të njëjtën mënyrë me të cilën Xhaka dhe Shaqiri provokoi futbollistët serbë në Kupën e Botës në Rusi. Dhe festimi i Ramos shkaktoi debat të gjerë, madje edhe te tifozët e Kroacisë në rrjetet sociale. Tutje, "Kurir" shkruan se festa me shqiponjë nënkupton simbolin kombëtar shqiptar-konkretisht, "Shqipërinë e Madhe". Dhe normalisht ky koncept nuk është pritur aspak mirë nga tifozët dhe mediet serbe.

### Shaqiri: Konkurrenca na bën mirë ne lojtarëve

Xherdan Shaqiri është i bindur se Liverpooli do ta vazhdojë performancën pozitive duke qëndruar në krye të renditjes në këtë fillim sezoni, e kjo duke filluar nga sfida e së shtunës me Tottenhamin. Gjithsesi, ata po përgatiten për një "sulm" të fortë, pasi do të zhvillojnë 7 ndeshje në 23 ditë, duke përfshirë dy me Chelsean dhe ndeshjet e Ligës së Kampionëve kundër PSG-së dhe Napolit. Testi i vërtetë i sezonit është të shtunën në Wembley, ku sezonin e kaluar humbisnin në shifrat 4-1. Për këtë sfidë e të tjerat për "Sky Sport", Shaqiri ka thënë: "Po pres ndeshjen, veçanërisht tani pasi në javët e ardhshme kemi shumë ndeshje të mira dhe të forta. Por, do të përpiqemi ta mbajmë performancën tonë të mirë dhe shpresoj të fitojmë shumë ndeshje". Më pas sulmuesi shqiptar ka shtuar: "Ne stërvitemi shumë çdo ditë. Ju mund të shihni se në skuadrën tonë ka cilësi dhe ne punojmë shumë. Konkurrenca në futboll është shumë e mirë për lojtarët".

## Sonte Kosova përballet me Maqedoninë

PRISHTINË, 12 SHTATOR - Përfaqësuesja e Kosovës sonte (e enjte) nga ora 20:45 do të përballet në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë me Maqedoninë, në kuadër të parakualifikimeve për FIBA Eurobasket 2021. Kapiteni Dardan Berisha ka thënë se Kosova sërish do ta mposhtë Maqedoninë ashtu sikurse në vitin e kaluar. "Jemi shumë të motivuar. Maqedoninë e kemi mposhtur vitin e kaluar, por mund ta mposhtim prapë para shikuesve tanë. Trajneri i ri është me ne, e që është freski për ekip. Ka bërë një punë shumë të mirë me ne. E dimë se çfarë ka qenë kur ka luajtur basketboll. Përvoja e tij na ka përcjellë neve", ka thënë Berisha.
12 lojtarët që do të luajnë për Kosovën në këtë ndeshje janë: Mirza Ahmetbasiq, Erjon Kastrati, Dardan Berisha, Leonard Mekaj, Valon Bunjaku, Scott Bamforth, Rron Ukaj, Ergin Grosha, Lis Shoshi, Fisnik Rugova, Alban Veseli dhe Gëzim Morina.



# Gashi: Vitin e ardhshëm do ta ndërtojmë kampin stërvitor në Obiliq

PRISHTINË, 12 SHTATOR - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka thënë se projekti i tri fushave ndihmëse në Obiliq është një prej projekteve kapitale që e financon UEFA. Sipas tij, ky projekt është në kuadër të ngritjes së cilësisë, avancimit të infrastrukturës sportive në Republikën e Kosovës. "Është një projekt i përbashkët trepalësh në mes të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Komunës së Obiliqit dhe Federatës së Futbollit të Kosovës. Punimet do t'i menaxhojë Federata, kurse financimin do ta bëjë UEFA. Ministria dhe kryetari kanë qenë jashtëzakonisht të përkushtuar që në afat rekord ta sigurojmë edhe hapësirën edhe parcelën, në të njëjtën kohë të mundësojmë këtë investim që do të jetë një prej investimeve më të mëdha në Komunën e Obiliqit në infrastrukturën sportive dhe natyrisht ky projekt është në kuadër të ngritjes së cilësisë, avancimit të infrastrukturës sportive në Republikën e Kosovës", ka thënë ministri Gashi, i cili e përgëzoi kryetarin Gashi për përkushtimin e tij për ndarjen e hapësirave të lokacionit për ndërtimin e tri fushave ndihmëse. Ndërkaq kryetari Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi, ka deklaruar: "Këto janë takime të rregullta ku ne konsultohemi bashkë për bashkëpunim". Gjatë vizitës në stadiumin "Agron Rama" i pranishëm ishte edhe kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, i cili ka falënderuar kryetarin e Obiliqit, por edhe asamblistët e Kuvendit Komunal të cilët kanë vendosur ta japin këtë pronë në shërbim të kampit nacional të futbollit që do të bëhet në koordinim me UEFA-n dhe FIFA-n. Kryetari Ademi e ka falënderuar edhe ministrin Gashi për angazhimin e tij për krijimin e kushteve për të investuar në infrastrukturën sportive në vend.



# Formula 1, një realitet i mundshëm për djalin e Michael Schumacherit

BERLIN, 12 SHTATOR - Botërori i Formulës 1 duket se shumë shpejt do të ketë një tjetër Schumacher në pistë. Bëhet fjalë për Mick Schumacher, djalin e legjendës shtatë herë kampion bote, Michael që, me sa duket, është vënë në shënjestrën e Toro Rossos. Piloti 19-vjeçar po bën paraqitje fantastike këtë sezon në kampionatin F3 të Federatës Ndërkombëtare të Automobilizmit (FIA) dhe këtë e vërtetojnë fitoret e dy garave, më e fundit në Çmimin e Madh të Nurburgringut fundjavën e kaluar, që i jep mundësinë atij t'i afrohet gjithnjë e më shumë kreut të renditjes, që mbahet nga Dan Ticktum me një diferencë prej vetëm 16 pikësh. Në fakt, në 10 ndalesat e fundit në këtë kampionat ai ka arritur të fitojë gjashtë prej tyre dhe në të njëjtën kohë ka qenë konstant në paraqitjet e tij, pasi në vetëm tri raste nga 24 raunde nuk e ka përfunduar garën. Kjo ka bërë që Helmut Marko të kontaktojë me Mick Schumacherin dhe përfaqësuesit e tij, për të parë nëse ekzistojnë mundësitë që ai të jetë pjesë e Formulës 1 në vitin 2019. Mick Schumacher e ka të sigurt marrjen e superlicencës për të garuar në këtë kampionat, duke qenë se ka marrë 20 pikë nga 40 të nevojshmet, të cilave do t'u shtohen edhe ato që do të fitojë nga pozicionimi mes tri vendeve të para në F3. Problemi në këtë pikë qëndron te presioni që do të ushtrohet te Mick Schumacher, nëse do të bëjë këtë kalim të shpejtë në Formulën 1, ndërkohë që plani është që sezonin tjetër, ai të garojë në F2 me skuadrën aktuale "Prema". Presioni i madh mbi të mund të bëjë që gjërat të mos shkojnë mirë për 19-vjeçarin në Formulën 1, diçka që familjarët e tij nuk duan të ndodhë.




### SHKURT

## Di Marzio lavdëron Kosovën

Gianluca Di Marzio i ka kushtuar një artikull Përfaqësueses së Kosovës në futboll pas ndeshjeve të para në Ligën e Kombeve. "Fitorja e fundit ndaj Ishujve Faroe i dedikohej ish-presidentit të FFK-së, të ndarë nga jeta në qershor, i cili ishte edhe i pari që luftoi për të drejtat e futbollit në Kosovë", shkruan Di Marzio që, po ashtu, ka plot lëvdata për selektorin e Kosovës, Bernard Challandes.
Di Marzio ka lavdëruar edhe opsionet në ekipin e Kosovës përfshirë Milot Rashicën, Samir Ujkanin, Donis Avdijajn dhe të tjerët. "Milot Rashica veçohet për shpejtësinë dhe asistimet e tij. Edhe Ujkani, një njohje e vjetër për futbollin italian, tashmë është një rekordmen për praninë në kombëtare. Donis Avdiaj, 22-vjeçari që është aktivizuar me të rinjtë e Gjermanisë, por në fund zgjodhi Kosovën prej prindërve. Gjithashtu, edhe Berisha i Lazios, Kryeziu tek Zyrihu apo edhe Muriqi në Turqi tek Rizesspori. Kaq shumë emra e talente për Kosovën, që pritet të jetë një kombëtare gjithmonë e në rritje në arenën ndërkombëtare", ka shkruar Di Marzio.

## Gundogani refuzon Barçën për Cityn

Mesfushori i Kombëtares së Gjermanisë, Ilkay Gundogan, e ka refuzuar ofertën e Barcelonës për ta vazhduar karrierën me Manchester Cityn. "The Sun" raporton se 27-vjeçari ka hedhur poshtë çdo mundësi për t'u larguar nga kampionët e Anglisë, sepse dëshiron ta vazhdojë punën me trajnerin Pep Guardiola, i cili e mori nga Borussia Dortmund në vitin 2016.

## Tevezi: Ky është dallimi në mes të Messit dhe Ronaldos

Ish-sulmuesi i Argjentinës dhe Manchester Unitedit, Carlos Tevez, ka folur për dy lojtarët më të mirë në botë në dekadat e fundit, Lionel Messin dhe Cristiano Ronaldon, duke e treguar një dallim mes tyre. "Kurrë nuk e kam parë Messin në palestër. Kurrë nuk e kam parë Messin duke stërvitur si ta ndalë topin apo ushtrime të tilla. Për të gjithçka vjen natyrshëm, megjithëse penalltitë i ka ushtruar. Në fillim nuk i gjuante, por tani i gjuan vazhdimisht në qoshe", ka thënë Tevezi. "Ndërsa Cristiano gjithmonë ndalej në palestër pas stërvitjeve. E kishte fiksim, dhe për të qenë më i miri në çdo aspekt, ai gjithmonë vinte i pari. Kur kishin stërvitje në nëntë të mëngjesit, unë shkoja në tetë, por e gjeja Ronaldon aty. Edhe nëse shkoja në 7:30, prapë e gjeja aty. Fillova ta pyes veten: 'Si ta heq qafe këtë njeri?' Një ditë, shkova në stërvitje në gjashtë të mëngjesit, por ai ishte aty! I përgjumshëm, por ishte aty", ka deklaruar Tevezi.

## Rakitic: Modriqi e meriton çmimin, Messi më i miri në histori

Ivan Rakitiq e ka përsëritur se Luka Modriqi e meritoi çmimin e lojtarit më të mirë për vitin 2018 pavarësisht se Lionel Messi është lojtari më i mirë në histori. "Lojtari më i mirë në botë është Messi dhe më i miri ndonjëherë, por Luka ka qenë më i miri në 2018-n. Si i tillë, unë e kam sqaruar se Luka meriton çmimet individuale këtë vit dhe si çdo kroat tjetër, jam i lumtur për të me këto nominime. Dua ta shoh atë të vazhdojë të fitojë çmime", ka thënë Rakitiqi, i cili foli edhe për mesfushorin Sergio Busquets. "Ai është mesfushori qendror më i mirë në botë. Është kënaqësi të luash me të, por nuk mund ta krahasosh me Modriqin, sepse janë ndryshe. Ata janë më të mirët dhe unë kam privilegjin që luaj me të dy", ka shtuar Rakitiqi.

C.nr.152/2018

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË** , departamenti i përgjithshëm, gjyqtari Faton Ademi në çështjen juridike të paditësit; Arben Haxha nga Mitrovica të cilin sipas autorizimit me shkrim e përfaqeson Av. Besart Kadriu nga Mitrovica kundër të paditurit; Elvisa Bakic nga Sajenica tani me adresë të panjohur në Gjermani, gjykata me datën 11.09.2018 konform nenit 79.3 të LPK-së mori këtë;

## A K T V E N D I M

**I** **Caktohet Av. Ali Rexha** nga Mitrovica si përfaqësues i përkohshëm i të paditurit; Elvisa Bakic nga Sajenica tani me adresë të panjohur në Gjermani

**II** Përfaqesuesi i përkohshëm në kuptim të nenit 82 të LPK-se i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjorë, të cilat i ushtron deri sa të paraqiten në gjykatë të paditurit apo përfaqësuesi me prokurë, respektivisht deri sa organi i kujdestarisë ta njoftojë gjykatën se e ka caktuar kujdestarinë

**III** Ky aktvendim në afat prej shtatë ditësh të shpallet në tabelën e shpalljes së gjykates, të botohet në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës , si dhe të botohet në njëren nga gazetat ditore të Kosovës apo sipas nëvojes të shpallet në ndonje mënyrë tjetër të përshtatshme

**IV** Shpenzimet për përfaqesuesin e përkohshëm bien në barë palës paditëse.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**

**C.nr.152/2018 me datën 11.09.2018**

**G J Y Q T A R I**

**Faton Ademi**

**UDHËZIM JURIDIK –** kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa

C.nr.13/2018

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË** , departamenti i përgjithshëm, gjyqtari Faton Ademi në çështjen juridike të paditësit; Albulena Metaj nga fsh Pirq Komuna e Mitrovicës të cilës sipas autorizimit me shkrim e përfaqeson Av. Isa Hyseni nga Mitrovica kundër të paditurit; Sadik Metaj nga Wien-Austri tani me adresë të panjohur në Austri, gjykata me datën 11.09.2018 konform nenit 79.3 të LPK-së mori këtë;

## A K T V E N D I M

**I** **Caktohet Av. Bashkim Mehana** nga Mitrovica si përfaqësues i përkohshëm i të paditurit; Sadik Metaj nga Wien-Austri tani me adresë të panjohur në Austri

**II** Përfaqesuesi i përkohshëm në kuptim të nenit 82 të LPK-se i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjorë, të cilat i ushtron deri sa të paraqiten në gjykatë të paditurit apo përfaqësuesi me prokurë, respektivisht deri sa organi i kujdestarisë ta njoftojë gjykatën se e ka caktuar kujdestarinë

**III** Ky aktvendim në afat prej shtatë ditësh të shpallet në tabelën e shpalljes së gjykates, të botohet në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës , si dhe të botohet në njëren nga gazetat ditore të Kosovës apo sipas nëvojes të shpallet në ndonje mënyrë tjetër të përshtatshme

**IV** Shpenzimet për përfaqesuesin e përkohshëm bien në barë palës paditëse.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**

**C.nr.13/2018 me datën 11.09.2018**

**G J Y Q T A R I**

**Faton Ademi**

**UDHËZIM JURIDIK –** kundër këtijë aktvendimi nuk është e lejuar ankesa

GLV VITIA

**BAZUAR NË THIRRJEN PËR APLIKIM PËR MASËN 303 DHE NËNMASAT 1,2 dhe 3 PËR**

**FUNKSIONALIZIMIN E GLV-ve TË PËRZGJEDHURA 2018**

NGA MINISTRIA E BUJQËSISË PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL – AGJENCIA PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË

**GRUPI LOKAL I VEPRIMIT“ VITIA” SHPALL:**

## KONKURS

PËR PRANIMIN E MENAXHERIT TË GLV-së “ VITIA”

**Fushëveprimtaria e punës:**

1.Njohja me LEADER

2.Zbatimi i kritereve të LEADER-it

3. Të ketë njohuri me politikat e BE-së

4. Identifikimin / Zhvillimin e projektit në pajtim me Strategjinë Zhvillimore Lokale ( SZHL )

4. Bashkëpunues me strukturat lokale

5. Eksperiencë në menaxhimin e projekteve

6. Aftësi në organizimin e trajnimeve

7. Raporte mujore për aktivitetet e kryera

8. Një raport përfundimtar me rezultatet e arritura

**Profili:**

1. Diplomë Universitare
2. C V – në
3. Njohës I mire I gjuhës angleze
4. Përparësi – Fakulteti i Bujqësisë ,Ekonomisë , Menaxhimit, Agroekonomisë etj.
5. Përvojë profesionale në zhvillimin e projekteve lidhur me bujqësi dhe zhvillim rural është i mirëseardhur
6. Trajnim i veçantë në fushën e zhvillimit lokal apo të qëndrueshëm do të ishte përparësi

**Aftësitë:**

1. Të jetë autoritativ
2. Aftësi në komunikim
3. Përvojë si trajner
4. Të jetë motivues
5. Menaxher i burimeve dhe informatave
6. Aftësi për hartimin e planit të veprimit
7. Të ketë aftësi për partneritet
8. Të jetë promovues
9. Të mbështesë aktivitetet e Rrjetit
10. Të punoj jo i izoluar
11. Të jetë kërkues i burimeve të tjera

**Dokumentet për aplikim:**

- Dëshmia për përgatitjen profesionale / Diploma
- Formulari për aplikim
- Të dhënat personale / CV për kandidatin
- Letër motivimi
- Vërtetim që nuk është nën hetime
- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës
- Çertifikata e lindjes
- Referencë

Aplikacionet dorëzohen në zyrën e Grupit Lokal të Veprimit , kati i dytë, nr. 4 – në objektin e Shtëpisë së Kulturës

“ Gursel e Bajram Sylejmani” - nëViti- nga ora $9^h$ – $15^h$

Afati i aplikimit është 7 ( shtatë ) ditë nga dita e shpalljes në media.

Afati i kontratës zgjatë një vit, orari është 4 ( katër ) orë në ditë, paga mujore 220 € bruto.

VITI

Më: 12.09.2018

Kryetarja e GLV-së

GRUPI LOKAL I VEPRIMIT GLV VITIA LOCAL ACTION GROUP LAG VITI

Fadile Demelezi

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada - Government***

Zyra e Kryeministrit –Ured Premijera –Office of the Prime Minister

*Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo Agency of Statistics*

Duke u bazuar ne Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civilë të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2010 Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës , *Agjencia e Statistikave të Kosovës* shpallë:

## KONKURS

**1.Departamenti i Metodologjisë dhe TI-së një ( 1 ) pozitë të karrierës:**

**Titulli: Një ( 1) Administrator i Lartë i TI-së për baza të të dhënave**

**Numri i referencës : ASK-DMTI-se -001**

**Koeficienti : 8**

**Detyrat dhe përgjegjësitë :**

1. Instalimi, konfigurimi, dizajnimi i bazës së të dhënave, migrimi, monitorimi i performancës, siguria dhe zgjidhja e problemeve;
2. Përgjegjës për operacione, arkitekturë dhe mirëmbajtje të Bazave së të Dhënave (MS SQL, MySQL, PC-Axis dhe SDMX databasse) dhe Internet Application server për sistemet e ASK-së;
3. Zhvillon protokollet e automatizimit për ngarkimin e të dhënave statistikore dhe hapësinore duke përdorur modelimin e të dhënave dhe hartimin e atributeve dhe menaxhon rutinat e definuara të punës;
4. Zhvillon dhe krijon procedurat për bazën e të dhënave statistikore dhe integrimin e tyre në sistemin e PC-Axis dhe GIS-it dhe monitoron serverët dhe performancën e tyre.
5. Harton, dokumenton dhe ndërton arkitekturën dhe skemën e bazës së të dhënave;
6. Zhvillon dhe harton strategjinë e bazës së të dhënave, monitoron sistemet dhe kontribuon në përmirësimin e përformancës dhe kapacitetin e bazës së të dhënave, dhe planifikimin e kërkesave për zgjerim të ardhshëm.
7. Krijimi dhe mirëmbajtja e kopjeve rezervë (backup) dhe përgatit procedurat për restaurimin e tyre (skenarët për backup dhe restore);
8. Punët tjera shtesë të cilat kërkohen nga udhëheqësi i divizionit.

- **Kualifikimi :** Diplomë Universitare në Shkenca kompjuterike.
- **Përvoja e punës**: Kandidati duhet ti ketë 3 vite përvojë pune profesionale në administrimin e bazës së të dhënave dhe programim.
- **Kompetenca dhe aftësitë:**
- Njohje e punës me programet: MS SQL Server, GIS, PC-Axis, SDMX, SPSS, STATA;
- Njohuri mbi ndonjë nga gjuhet programuese: C#, VB .NET përparësi;
- Çertifikata shtesë nga fushat e Teknologjisë Informative dhe programeve statistikore që ndërlidhen me vendin e punës përparësi;
- Njohja e gjuhës angleze.

**2.Departamenti i Statistikave sociale tri ( 3 ) pozita të karrierës:**

**Titulli: Një ( 1) Zyrtar i lartë i Regjistrit të Popullsisë**

**Numri i referencës : ASK-DSS-002**

**Koeficienti : 8**

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

1. Planifikimi i kapaciteteve, instalimi, konfigurimi, dizajnimi i bazës së të dhënave të popullsisë, si dhe instalimi i sistemit të sigurisë së bazës së të dhënave të Regjistrit të Popullsisë;
2. Zhvillimi i moduleve të ndryshme për marrjen/transmetimin e të dhënave nga institucionet tjera.
3. Krijimi dhe mirëmbajtja e kopjeve rezervë (backup) si dhe përgatit procedurat për restaurimin e tyre (skenarët për backup dhe restore);
4. Përgjegjës për operacione, arkitekturë dhe mirëmbajtje të Bazave të Shënimeve (MS SQL, MySQL, PC-Axis dhe SDMX databasse) dhe Internet Application server për sistemet e ASK-së;
5. Azhurnimi i të dhënave të Regjistrit të Popullsisë në baza, mujore, tremujore dhe vjetore (varësisht nga burimi i të dhënave) nga burimet tjera (ARC, Ministria e Arsimit, Ministria e Shëndetësisë si dhe shumë Institucione tjera përfshi regjistrimet, anketat dhe hulumtimet tjera statistikore).
6. Zhvillon dhe harton strategjinë e bazës së të dhënave, monitoron sistemet dhe kontribuon në përmirësimin e performancës dhe kapacitetin e bazës së të dhënave, dhe planifikimin e kërkesave për zgjerim të ardhshëm si dhe është përgjegjës për vlerësimin e kuantitetit dhe kualitetit të të dhënave.
7. Krijimi i tabelave të ndryshme të kryqëzuara dhe nxjerrja e raporteve nga baza e të dhënave sipas kërkesave të stafit dhe dërgimi/transmetimi tek institucionet tjera si dhe respektimi i afateve të parapara.
8. Punët tjera shtesë të cilat kërkohen nga eprori.

- **Kualifikimi : Diplomë Universitare në Shkenca kompjuterike.**
- **Përvoja e punës**: kandidati duhet të ketë 3 vite përvojë pune profesionale në administrimin e bazës së të dhënave dhe programim.
- **Kompetenca dhe aftësitë:**
- Njohje e punës me programet: MS SQL Server, GIS, PC-Axis, SDMX, SPSS, STATA;
- Njohuri mbi ndonjë nga gjuhet programuese: C#, VB .NET përparësi;
- Çertifikata shtesë nga fushat e Teknologjisë Informative dhe programeve statistikore që ndërlidhen me vendin e punës përparësi;
- Shkathtësi në komunikim dhe i gatshëm në kryerjen e detyrave të punës ne kohen e përcaktuar;
- Njohja e gjuhës angleze.

**-Titulli: Një ( 1) Zyrtar i lartë i statistikave të varfërisë**
**Numri i referencës : ASK-DSS-003**

**Koeficienti : 8**

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

1. Bën monitorimin e grumbullimit të të dhënave të anketës mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës (SILC);
2. Angazhohet në përpunimin, analizimin dhe nxjerrjen e rezultateve të anketës mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës ;
3. Angazhohet në përgatitjen e publikimit të varfërisë;
4. Angazhohet në përgatitjen e micro të dhënave të SILC, për transmetim në Eurostat;
5. Kontribuon në ngritjen e cilësisë së të dhënave të SILC;
6. Angazhohet në projektet që zhvillohen në njësinë e statistikave të standardit jetësor;
7. Merr pjesë në trajnime dhe vizita të organizuara nga ASK-ja apo nga ndonjë donatorë tjetër me qëllim të ngritjes së kapacitetit të njohurive lidhur me përpunimin dhe analizimin e të dhënave në fushën e statistikave të të ardhurave dhe kushteve të jetesës si dhe statistikave të varfërisë;
8. Kryen edhe punë tjera me kërkesë të eprorit.

- **Kualifikimi :** Diplomë universitare nga fusha e ekonomisë.
- **Përvoja e punës**: Kandidati duhet të ketë 3 vite përvojë pune profesionale.
- **Kompetenca dhe aftësitë:**
- Njohuri në kalkulimet statistikore (pastrimin e të dhënave, inputim, validim dhe analizim);
- Njohuri profesionale mbi treguesit e kushteve të jetesës si dhe të varfërisë;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike;
- Shkathtësi në komunikim;
- Azhur dhe i gatshëm në kryerjen e detyrave të punës;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Exel, Power Point dhe sidomos njohuri të theksuara te programit për analiza statistikore SPSS, STATA, përparësi do të jetë njohja e programit SAS);
- Njohja e gjuhës angleze.

**-Titulli: Një ( 1) Zyrtar i lartë i Statistikave të Tregut të Punës**

**Numri i referencës : ASK-DSS-004**

**Koeficienti : 8**

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

1. Bën monitorimin e grumbullimit të të dhënave të Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP);
2. Kontrollon dhe përmirëson gabimet eventuale gjatë grumbullimit të të dhënave të AFP-së;
3. Angazhohet në përpunimin, analizimin dhe nxjerrjen e rezultateve të Anketës së Fuqisë punëtore kuartale dhe vjetore;
4. Angazhohet në përgatitjen e micro të dhënave të AFP-së, tremujore dhe vjetore, për transmetim në Eurostat;
5. Kontribuon në ngritjen e cilësisë së të dhënave të AFP-së;
6. Angazhohet në projektet që zhvillohen në njësinë e statistikave të tregut të punës;
7. Merr pjesë në trajnime dhe vizita të organizuara nga ASK-ja apo nga ndonjë donatorë tjetër me qëllim të ngritjes së kapacitetit të njohurive lidhur me përpunimin dhe analizimin e të dhënave në fushën e statistikave të tregut të punës;
8. Kryen edhe punë tjera me kërkesë të eprorit.

- **Kualifikimi : Diplomë universitare nga fushat e Ekonomisë.**
- **Përvoja e punës**: Kandidati duhet të ketë 3 vite përvojë pune profesionale.
- **Kompetenca dhe aftësitë:**
- Njohuri në kalkulimet statistikore;
- Njohuri profesionale mbi treguesit e tregut të punës;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike;
- Shkathtësi në komunikim;
- Azhur dhe i gatshëm në kryerjen e detyrave të punës;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Exel, Power Point dhe sidomos njohuri te theksuara te programeve për analiza statistikore SPSS dhe STATA);
- Njohja e gjuhës angleze.

**3. Departamenti i Llogarive Kombëtare tri ( 3 ) pozita të karrierës:**

**Titulli: Një ( 1) Zyrtar i lartë për statistika të informalitetit**
**Numri i referencës : ASK-DLLK-005**

**Koeficienti : 8**

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

Përgatitja e të dhënave të informalitetit, si pjesë e Bruto Produktit Vendor (BPV) me qasjen e prodhimit dhe të shpenzimeve (realizimi i planit sipas afatit, implementimi i metodologjive të reja sipas planit vjetor të paraparë, përmirësimi i kualitetit përmes aktiviteteve shtesë me shpjegime metodologjike);

1. Vë në shfrytëzim standardet dhe metodologjitë e Eurostatit (ESA), Statistikave të Kombeve të Bashkuara (SNA) dhe udhëzuesit të Organizatës për Zhvillim dhe bashkëpunim Ekonomik (OECD);
2. Këshillon dhe udhëzon personelin në nivelin më të ulët profesional dhe mund të udhëheqë një grup punues në projekte të caktuara;
3. Këmbimi i përvojave me bashkëpunëtoret e departamentit;
4. Bashkëpunon me sektorët tjerë brenda ASK dhe institucionet e ndryshme të të dhënave, me qëllim të sigurimit të të dhënave të nevojshme;
5. Punon në përgatitjen e publikimit të të dhënave të ekonomisë jo formale si pjese e publikimeve të BPV me të dy qasjet;
6. Punët rreth projekteve të parapara në Llogari Kombëtare;
7. Punë të tjera që i jepen nga ana e eprorit të tij.

- **Kualifikimi :** Diplomë universitare nga fushat e Ekonomisë.
- **Përvoja e punës**: Kandidati duhet të ketë 3 vite përvojë pune profesionale .
- **Kompetenca dhe aftësitë:**
- Njohuri për indikatorët makroekonomik (njohuri profesionale në fushën e Llogarive Kombëtare);
- Shkathtësi dhe nivel të lartë të absorbimit të njohurive nga Asistenca Teknike dhe leximi i manualeve dhe metodologjive të aplikuara në sistemet statistikore për Llogaritë Kombëtare.
- Kërkohet aftësia për të punuar dhe komunikuar me autoritete të brendshme dhe të jashtme në nivel të njëjtë, të lartë ose më të ulët si dhe dhënia e këshillave në fushën përkatëse të përgjegjësisë;
- Nivel të lartë të bashkëpunimit në punë ekipore.
- Të ketë shkathtësi të dëshmuara dhe efektive të komunikimit me shkrim dhe me gojë

– Entuziast dhe energjik
– Azhur dhe i gatshëm në kryerjen e detyrave
– Njohuri të punës me kompjuter (*Word, Excel, Access dhe programe aplikative tjera)*
– Njohja e gjuhës angleze.

**Titulli: Një ( 1) Zyrtar i lartë i Llogarive Qeveritare**
**Numri i referencës : ASK-DLLK-006**
**Koeficienti : 8**

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

1. Përpilimi i Llogarive Qeveritare, dhe komponentëve tjera të Bruto Produktit Vendor, (BPV) me qasjen e prodhimit dhe të shpenzimeve me çmime aktuale dhe konstante (realizimi i planit sipas afatit kalendarik, implementimi i metodologjive të reja sipas planit vjetor të paraparë, përmirësimi i kualitetit përmes aktiviteteve shtesë me shpjegime metodologjike);
2. Vë në shfrytëzim standardet dhe metodologjitë e Eurostatit (ESA), Statistikave të Kombeve të Bashkuara (SNA) dhe GFS;
3. Këshillon dhe udhëzon personelin në nivelin më të ulët profesional dhe mund të udhëheqë një grup punues në projekte të caktuara;
4. Këmbimi i përvojave me bashkëpunëtorët në kuadër të departamentit;
5. Bashkëpunon me sektorët tjerë brenda ASK dhe institucionet e ndryshme te të dhënave, me qëllim të sigurimit të të dhënave të nevojshme;
6. Punon në përgatitjen e publikimit të Llogarive Qeveritare, dhe ndihmon në përgatitjen e publikimeve të BPV me qasjen e prodhimit dhe qasjen e shpenzimeve;
7. Punët rreth projekteve të parapara në Llogari Kombëtare;
8. Punë të tjera që i jepen nga ana e eprorit të tij.

– **Kualifikimi :** Diplomë universitare nga fushat e Ekonomisë.
– **Përvoja e punës**: Kandidati duhet të ketë 3 vite përvojë pune profesionale .
– **Kompetenca dhe aftësitë:**
– Njohuri për indikatorët makroekonomik( njohuri profesionale në fushën e Llogarive Kombëtare dhe Qeveritare);
– Shkathtësi dhe nivel të lartë të absorbimit të njohurive nga Asistenca Teknike dhe leximi i manualeve dhe metodologjive të aplikuara në sistemet statistikore për Llogaritë Kombëtare.
– Kërkohet aftësia për të punuar dhe komunikuar me autoritete të brendshme dhe të jashtme në nivel të njëjtë, të lartë ose më të ulët, si dhe dhënia e këshillave në fushën përkatëse të përgjegjësisë;
– Nivel të lartë të bashkëpunimit në punë ekipore;
– Të ketë shkathtësi të dëshmuara dhe efektive të komunikimit me shkrim dhe me gojë;
– Entuziast dhe energjik;
– Azhur dhe i gatshëm në kryerjen e detyrave;
– Njohuri të punës me kompjuter (Word, Excel, Access dhe programe aplikative tjera);
– Njohja e gjuhës angleze.

**Titulli: Një ( 1) Zyrtar për Statistika të Informalitetit**
**Numri i referencës : ASK-DLLK-007**
**Koeficienti : 7**

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

1. Përpilimi i të dhënave të informalitetit si pjesë e Bruto Produktit Vendor (BPV) me qasjen e prodhimit dhe të shpenzimeve (realizimi i planit sipas afatit);
2. Implementimi i metodologjive të reja sipas planit vjetor të paraparë, përmirësimi i kualitetit përmes aktiviteteve shtesë me shpjegime metodologjike);
3. Vë në shfrytëzim standardet dhe metodologjitë e Eurostatit (ESA), Statistikave të Kombeve të Bashkuara (SNA) si dhe Udhëzuesit të Organizatës për Zhvillim dhe bashkëpunim Ekonomik (OECD);
4. Këmbimi i përvojave me bashkëpunëtorët ne kuadër te Llogarive Kombëtare;
5. Bashkëpunon me sektorët tjerë brenda ASK dhe institucionet e ndryshme të të dhënave, me qëllim të sigurimit të të dhënave të nevojshme;
6. Punon në përgatitjen e publikimit të të dhënave të ekonomisë jo formale si pjesë e publikimeve të BPV me qasje të prodhimit dhe shpenzimeve;
7. Punët rreth projekteve të parapara në Llogari Kombëtare;
8. Punë të tjera që i jepen nga ana e eprorit të tij.

– **Kualifikimi :** Diplomë universitare nga fushat e Ekonomisë.
– **Përvoja e punës**: Kandidati duhet të ketë 2 vite përvojë pune profesionale .
– **Kompetenca dhe aftësitë:**
– Njohuri për indikatorët makroekonomik;
– Shkathtësi dhe nivel të lartë të absorbimit të njohurive nga Asistenca Teknike, leximi i manualeve dhe metodologjive të aplikuara në sistemet statistikore për Llogaritë Kombëtare.
– Kërkohet aftësia për të punuar dhe komunikuar me autoritete të brendshme dhe të jashtme në nivel të njëjtë, të lartë ose më të ulët;
– Nivel të lartë të bashkëpunimit në punë ekipore;
– Të ketë shkathtësi të dëshmuara dhe efektive të komunikimit me shkrim dhe me gojë
– Entuziast dhe energjik;
– Azhur dhe i gatshëm në kryerjen e detyrave;
– Njohuri të punës me kompjuter (W*ord, Excel, Access dhe programe aplikative tjera);*
– Njohja e gjuhës angleze.

**4.Departamenti i Statistikave ekonomike një ( 1 ) pozitë të karrierës:**

**Titulli: Një ( 1) Zyrtar për Statistika të Investimeve**

**Numri i referencës : ASK-DSE-008**

**Koeficienti : 7**

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

1. Hartimi i planit për zhvillimin e hulumtimit për statistikat e investimeve;
2. Përgatitja dhe dizajnimi i pyetësorit për Anketën e Statistikave të investimeve;
3. Përcaktimi i kritereve për nxjerrjen e mostrës, mbajtja e trajnimeve anketuesve si dhe shpërndarja e listës së bizneseve tek anketuesit, së bashku me pyetësorët për grumbullimin e të dhënave;
4. Mbikëqyrja e procesit të anketës, kontrollimi i pyetësorëve të grumbulluar nga terreni, rishikimi i aktivitetit ekonomik në bazë të përshkrimit, kodimi i tyre si dhe mbikëqyrja gjatë fazës së përfshirjes së të dhënave;
5. Përpunimi, analizimi dhe publikimi i Statistikave të Investimeve. (realizimi i planit sipas afatit kalendarik, implementimi i metodologjive të reja sipas planit vjetor të paraparë, përmirësimi i kualitetit përmes aktiviteteve shtesë me përshkrime metodologjike);
6. Merr pjesë në trajnime edhe vizita të organizuara nga ASK-ja apo nga ndonjë donator tjetër me qëllim të ngritjes së kapacitetit të njohurive lidhur me përpunimin dhe analizimin e të dhënave në fushën e Statistikave të Investimeve.
7. Bashkëpunon me sektorët tjerë brenda ASK dhe institucionet e ndryshme të të dhënave, me qëllim të sigurimit të të dhënave të nevojshme si dhe punët rreth projekteve të parapara në statistikat ekonomike,
8. Punë të tjera që i jepen nga ana e eprorit të tij.

– **Kualifikimi :** Diploma universitare nga fushat e Ekonomisë.
– **Përvoja e punës**: Kandidati duhet të ketë 2 vite përvojë pune profesionale .
– **Kompetenca dhe aftësitë:**
– Njohuri për indikatorët makroekonomik;
– Shkathtësi dhe nivel të lartë të absorbimit të njohurive nga Asistenca Teknike, Leximi i manualeve dhe metodologjive të aplikuara në sistemet statistikore për statistikat ekonomike;
– Kërkohet aftësia për të punuar dhe komunikuar me autoritete të brendshme dhe të jashtme në nivel të njëjtë, të lartë ose më të ulët;
– Nivel të lartë të bashkëpunimit në punë ekipore;
– Azhur dhe i gatshëm në kryerjen e detyrave;
– Njohuri të punës me kompjuter (W*ord, Excel, Access dhe programe aplikative tjera);*
– Njohja e gjuhës angleze.

**5.Departamenti i Administratës dhe Mbështetjes një ( 1 ) pozitë të karrierës:**

**Titulli: Një ( 1) Zyrtar i Pasurisë**

**Numri i referencës : ASK-DAM-se -009**

**Koeficienti : 6**

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

1. Regjistron dhe administron pasurinë e institucionit në pajtim me procedurat e përcaktuara ligjore;
2. Përcjell lëvizjen e pasurisë dhe ofron informacione të duhura lidhur me lëvizjen e pasurisë dhe përgatit të gjithë dokumentacionin për lëvizjen e pasurisë –tjetërsimit;
3. Kontrollon dhe mirëmban të gjitha informatat e nevojshme për pasurinë në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi;
4. Bashkëpunon me zyrtarët për pranimin e pasurisë dhe me zyrtarët e financave për sigurimin e të dhënave të sakta dhe detajuara për pasurinë;
5. Përgatit dhe ofron të dhëna mbi vlerat e regjistruara të pasurisë për nevoja të raportimit financiar;
6. Në çdo fund vit dhe sipas nevojës i regjistron të dhënat mbi pasurinë në regjistrin e pasurisë pasi që pasuritë të jenë klasifikuar dhe të jetë kryer vlerësim nga ana e komisionit;
7. Siguron zbatimin e standardeve të kontabilitetit mbi evidentimin dhe zhvlerësimit pasurisë;
8. Kryen edhe detyra të tjera shtesë sipas kërkesës së eprorit të drejtpërdrejtë.

– **Kualifikimi :** Diploma universitare nga fushat e Ekonomisë.
– **Përvoja e punës**: Kandidati duhet të ketë 2 vite përvojë pune profesionale .
– **Kompetenca dhe aftësitë:**
– Të ketë aftësi profesionale specifike në menaxhimin dhe administrimin e pasurisë;
– Aftësi në zgjidhjen e problemeve për çështje teknike ose procedurale që dalin nga procesi i punës;
– Aftësia për të organizuar punën e vetë dhe për të koordinuar stafin e nivelit administrativ;
– Shkathtësi hulumtuese, analitike dhe të vlerësimit të informacionit;
– Shkathtësi kompjuterike në aplikacione (Word, Excel, Powe Point, Access, etj).

**Procedura e konkurimit:**

Në Shërbimin Civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës, të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, përgatitje të nevojshme arsimore, aftësi profesionale për zbatimin e funksionit administrativ si dhe të kenë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

**Aktet ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë rekrutimin:**
Përzgjedhja e Shërbyesve Civilë bëhet në pajtim me Ligjin –Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civilë të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

**Kohëzgjatja e emërimit:** Sipas Ligjit të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës, në të cilën është përfshirë periudha e punës provuese prej një (1) viti.

**Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik.**

**Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve**:

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Agjencinë e Statistikave te Kosovës , Rr," Zenel Salihu " Nr.4 Prishtinë. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, dëshmi mbi përvojën e punës profesionale , vërtetimin nga Gjykata, që personi nuk është nën hetime dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës për të cilin konkuroni.
Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.
Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuara, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.
Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do ti nënshtrohen testimit me shkrim dhe intervistimit.
Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni me zyrën e personelit , në tel: 038- 20031149, prej orës 08:00 – 16: 00.

***"Shërbimi Civilë i Kosovës ofron mundësi të barabarta tëpunësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.***

***"Komuniteti jo - shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës".***

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*
Zyra e Kryeministrit –Ured Premijera –Office of the Prime Minister
*Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo Agency of Statistics*

Na osnovu Zakona Br. 03/Z-149 o Civilnoj Službi Kosova i Pravilnika Br.02/2010 o Procedurama Regrutacije u Civilnoj Službi Republike Kosova, Agencija za Statistiku Kosova raspisuje:

## KONKURS

**1. Odeljenje Metodologije i IT-a, jedna (1) pozicija od karijere:**

**Naziv radnog mesta: Jedan (1) Viši Administrator IT-a za baze podataka**

**Referentni broj: ASK-OMIT-a -001**

**Koeficijent: 8**

**Zadaci i odgovornosti:**

1. Instalacija, konfiguracija, dizajniranje baze podataka, migracije, praćenje učinka, sigurnost i rešavanje problema;
2. Odgovoran za operacije, arhitekturu i održavanje Baze Podataka(MS SQL, MySQL, PC-Axis i SDMX baze podataka) i servera Internet Applikacija za sisteme ASK-a;
3. Razvijanje protokola automatizacije za otpremanje statističkih i prostornih podataka koristeći modeliranje podataka i dizajniranje svojstva (atributa) i upravlja definisanim radnim rutinama;
4. Razvijanje i uspostavljanje procedura za bazu statističkih podataka i njihovu integraciju u PC-Axis i GIS sistemima i nadgleda njihove servere i performanse.
5. Dizajniranje, dokumentovanje i izrada arhitekture i šeme baze podataka;
6. Razvijanje i dizajniranje strategije baze podataka, praćenje sistema i doprinos u poboljšanju performansi i kapaciteta baze podataka i planiranju budućih potreba za proširenje.
7. Stvaranje i održavanje rezervnih kopija (backup) i priprema procedura za njihovo vraćanje (scenarije za rezervne kopije (backup) i vraćanje (restore));
8. Obavljanje drugih dodatnih zadataka na zahtev šefa divizije.

- **Kvalifikacija** : Univerzitetska diploma u Računarske Nauke,

**- Radno iskustvo**: Kandidat mora imati 3 godine profesionalno radno iskustvo u upravljanju baza podataka i programiranju;

**- Nadležnosti i veštine:**

- Poznavanje rada s programima: MS SQL Server, GIS, PC-Axis, SDMX, SPSS, STATA;
- Poznavanje nekog od programskih jezika: C#, VB .NET prednost;
- Dodatni sertifikati iz oblasti Informacione Tehnologije i statističkih programa koji su povezani sa poslom za koji konkurišete su prednost;
- Dobro poznavanje engleskog jezika.

**2. Odeljenje Socijalnih Statistika, tri (3) pozicije od karijere:**

**Naziv radnog mesta: Jedan (1) Viši Službenik Registra Stanovništva**

**Referentni broj: ASK-OSS-002**

**Koeficijent: 8**

**Zadaci i odgovornosti:**

1. Planiranje kapaciteta, instalacija, konfiguracija, dizajniranje baze podataka o stanovništvu i ugradnja sigurnosnog sistema baze podataka Registra stanovništva;
2. Razvijanje različitih modula za prijem / prenošenje podataka iz drugih institucija;
3. Stvaranje i održavanje rezervnih kopija (backup) i priprema procedura za njihovo vraćanje (scenarije za rezervne kopije (backup) i vraćanje (restore));
4. Odgovoran za operacije, arhitekturu i održavanje Baze Podataka(MS SQL, MySQL, PC-Axis i SDMX baze podataka) i servera Internet Applikacija za sisteme ASK-a;
5. Ažuriranje podataka Registra Stanovništva na mesečnom, kvartalnom i godišnjem nivou (u zavisnosti od izvora podataka) iz drugih izvora (ARC, Ministarstvo Obrazovanja, Ministarstvo Zdravstva i mnoge druge institucije, uključujući registracije, ankete i druga statistička istraživanja).
6. Razvijanje i dizajniranje strategije baze podataka, praćenje sistema i doprinos u poboljšanju performansi i kapaciteta baze podataka i planiranju budućih potreba za proširenje., takođe je odgovoran za procenu količine i kvaliteta podataka.
7. Stvaranje različitih ukrštenih tabela i izvlačenje izveštaja iz baze podataka u skladu sa zahtevima osoblja i slanje / prenošenje drugim institucijama, kao i poštovanje predviđenih rokova,
8. Obavljanje drugih dodatnih zadataka nadređenog.

- **Kvalifikacija** : Univerzitetska diploma u Računarske Nauke,

**Radno iskustvo**: Kandidat mora imati 3 godine profesionalno radno iskustvo u upravljanju baza podataka i programiranju;

**Nadležnosti i veštine:**

- Poznavanje rada s programima: MS SQL Server, GIS, PC-Axis, SDMX, SPSS, STATA;
- Poznavanja nekog od programskih jezika: C#, VB .NET prednost;
- Dodatni sertifikati iz oblasti Informacione Tehnologije i statističkih programa koji su povezani sa poslom za koji konkurišete su prednost;
- Komunikacijske veštine i spremnost za obavljanje radnih zadataka u određeno vreme.
- Dobro poznavanje engleskog jezika

**- Naziv radnog mesta: Jedan (1) Viši Službenik Statistika Siromaštva**

